



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
“Menaxhimi i Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve”**

Universiteti “Fan S. Noli”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Çlirim Duro

2. Prof. As. Edmond Kadiu

Maj 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “Menaxhimi i Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti “Fan S. Noli”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan.S.Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Marketing-Turizëm
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 372, datë 23.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 62, datë 15.03.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit / 2 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli shtatë (7)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE / 0 PAK v.a. 2024-2025 9 PAE / 0 PAK v.a. 2023-2024
18	Numri i studentëve:	5 Studentë v.a. 2024-2025 9 Studentë v.a. 2023-2024
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, ofrohet nga Universiteti “Fan S. Noli” dhe zhvillohet nën Fakultetin e Ekonomisë si dhe Departamentit Marketing-Turizëm. Programi është licensuar me Urdhër të MAS nr. 372, datë 23.09.2021.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i Ekonomisë përbëhet nga tre departamente: 1) Departamenti Financë-Kontabilitet; 2) Departamenti i Menaxhimit; 3) Departamenti Marketing-Turizëm, ku bën pjesë edhe programi i marrë në shqyrtim për akreditim. Këto departamente ofrojnë programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë.

Programi i studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, 60 ECTS dhe kohëzgjatje të rregullt 1 vit akademik.

Programi i studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Nga takimi me studentë të këtij programi studimi doli në pah që ata kanë mbështetje të vazhdueshme nga personeli akademik duke përfshirë studentët në punët e tyre kërkimore, organizmin e konferencave, organizimin e eventeve dhe përditësimin me të rejat më të fundit në fushën e turizmit dhe eventeve.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Draft-Raporti i vlerësimit të jashtëm është përgatitur nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ ka kaluar një trajnim paraprak nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit. Ky draft-raport përmban informacionet e mbledhura nga analiza e dokumentacionit të ofruar nga Institucioni dhe vizita e realizuar gjatë këtij procesi. Vlerësimet për secilin standard dhe fushë synojnë të pasqyrojnë sa më saktë performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (www.ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Çlirim Duro dhe Prof. As. Edmond Kadiu. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga koordinatori teknik e ASCAL Aviola Bardhi

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i ofruar ka luajtur një rol të rëndësishëm në përgatitjen e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Ky dokumentacion gjithashtu ka orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u diskutuan dhe u trajtuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat 05.03.2025-06.03.2025 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit të jashtëm në këtë raport ka pasqyruar me korrektësi dhe profesionalizëm cilësinë e ofrimit të programit të studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv për arritjet e institucionit në ofrimin e programit të studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, duke theksuar përpjekjet dhe rezultatet pozitive të arritura. Gjithashtu, GVJ ofron sugjerime dhe rekomandime që mendojmë se do të ndihmojnë personelin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, duke u përshtatur me standardet ndërkombëtare dhe duke përgatitur gjeneratën e ardhshme të profesionistëve.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se programet e studimit të ofruara nga UNIKO janë në përputhje me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Programi i studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve (MP_MTAE) ka një fokus të qartë në zhvillimin e turizmit dhe menaxhimin e resurseve kulturore dhe natyrore, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe promovimit të vlerave kombëtare. Nëpërmjet moduleve të ndryshme të programit, studentët trajnohen për të pasur një ndikim pozitiv në industrinë e turizmit, duke u siguruar që zhvillimi i kësaj industrie të jetë në përputhje me ruajtjen e kulturës dhe traditave. Programi përfshin aspekte të menaxhimit të atraksioneve kulturore, organizimin e eventeve që pasqyrojnë identitetin dhe vlerat kombëtare, si dhe promovimin e turizmit që ndihmon në forcimin e lidhjeve mes kulturës lokale dhe zhvillimit ekonomik. Gjithashtu, dokumentacioni tregon se programi është krijuar duke marrë parasysh nevojat dhe prioritetet kombëtare në fushat e turizmit, duke siguruar që ai të kontribuoni në zhvillimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare, duke përmbushur kështu kërkesat e ligjit dhe standardet e akreditimit për arsimin e lartë. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 1.3 Plani Strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit si dhe me fushën e veprimtarisë së tij. Misioni i institucionit është të ofrojë programe studimi të cilat janë të fokusuara në zhvillimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve në fusha që përkojnë me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik kombëtar. Programi i studimit, si pjesë e këtij

	misioni, synon zhvillimin e ekspertëve në fushën e menaxhimit të turizmit dhe organizimit të eventeve, duke pasur parasysh kërkesat e industrisë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përputhje me qëllimet e institucionit, programi ofron një trajnim të thelluar dhe praktik, i cili lidhet ngushtë me fushën e menaxhimit të turizmit dhe atraksioneve kulturore, duke siguruar një formim të balancuar ndërmjet teorisë dhe praktikës, dhe duke u mundësuar studentëve që të kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorëve kyç të turizmit dhe eventeve, si dhe të ruajnë dhe promovojnë vlerat kulturore kombëtare. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO Vizita në Institucion
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Bazuar në evidencat e dërguara si dhe vizita me personelin akademik, GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me strategjinë për zhvillim të institucionit, si dhe me Statutin dhe Rregulloren e tij. Ky program është një element i rëndësishëm i planit të zhvillimit të institucioni dhe është krijuar për të mbështetur dhe realizuar objektivat afatgjata të tij në fushën e arsimit të lartë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit. Programi është në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit, duke siguruar një lidhje të ngushtë me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin e vazhdueshëm të sektorëve të turizmit dhe eventeve. Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, programi i studimit është zhvilluar duke respektuar standardet dhe kriteret e kërkuara për ofrimin e një arsimi cilësor. <u>Referenca:</u> Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO Shtojca 1.3 Plan Strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin

kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit, duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe ndërkombëtar. Programi është krijuar për t'iu përgjigjur nevojave të zhvillimit të sektorëve të turizmit dhe eventeve në nivel kombëtar, duke siguruar që studentët të përgatiten për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendit. Ai mbështetet në strategjitë kombëtare të zhvillimit, siç janë Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Turizmit dhe prioritetet e tjera kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke siguruar që ai të mbështesë objektivat afatgjata të zhvillimit ekonomik të vendit. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO</i> <i>Shtojca 1.3 Plani Strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se programi i studimit është hartuar dhe ofruar në përputhje të plotë me kërkesat e strategjive kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me misionin dhe prioritetet e institucionit. Programi siguron një përgatitje cilësore dhe të qëndrueshme për studentët, duke kontribuar në zhvillimin e turizmit dhe menaxhimit të eventeve në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimet globale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e programit të studimit. Institucioni ka një histori të gjatë dhe të suksesshme në ofrimin e programeve të studimit në fushën e turizmit dhe menaxhimit, si dhe disponon personel akademik të kualifikuar dhe të specializuar që mbështet zhvillimin e këtij programi. Përveç kësaj, institucionit i janë siguruar burimet e nevojshme për mbështetje akademike dhe praktike, duke përfshirë infrastrukturën moderne. Këto kapacitete dhe burime e bëjnë të mundur ofrimin e një programi cilësor që është në përputhje me standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës.

	<u>Referenca:</u> <i>Vizita në Institucion</i> <i>Tabela permbledhese MTAE</i> <i>Shtojca 1.13 Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik</i> <i>Shtojca 1.15 Raport i kontrollit të MAS për kapacitete pritese</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit. Programi është hartuar në përputhje me klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane, duke siguruar që ai përmbush standardet akademike dhe kërkesat e përcaktuara për fushën e turizmit dhe menaxhimit të eventeve. Gjithashtu, programi është i integruar në mënyrë të natyrshme me fushat akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse, duke ofruar mundësi për zhvillimin e kërkimit dhe inovacionit në një sektor kyç për zhvillimin ekonomik dhe kulturor, në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Kodi i Programit të studimit është 71MP1015S. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit MTAE</i> <i>Shtojca 1.34 Rregullore e brendshme e FE</i> <i>Shtojca 2.15 Kodifikimi i programit të studimit MTAE</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e programit. Njësia përgjegjëse për këtë program, e cila është fokusuar në studimet e turizmit dhe menaxhimit, ofron mbështetje të plotë për zhvillimin dhe ofrimin e një programi që është në përputhje me fushën e saj akademike dhe kërkimore. Stafi i departament ka një ekspertizë të thelluar në fushat e turizmit, që janë bazë për zhvillimin e këtij programi. Departamenti Marketing-Turizëm bashkëpunon me departamente brenda FE si: departamenti i menaxhimit për mbulimin e disiplinave si menaxhimi i projektit dhe etika dhe ligjet e biznesit si dhe jashtë

	FE kur shikohet e arsyeshme me qëllim mbarëvajtjen e programit të studimit. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.34 Rregullore e FE, Kreu VI</i> <i>Shtojca 1.46 Rregullore e DMT</i> <i>Shtojca 2.9 CV-të e Stafit Akademik</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe informacionit të siguruar, GVJ konstaton se UNIKO ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim të ngushtë me punëdhënësit dhe partnerët ndërkombëtarë. Kjo siguron që studentët e diplomuar të kenë qasje në mundësi trajnimi që janë të përshtatura me kërkesat dinamike të tregut dhe përvojat ndërkombëtare, të cilat janë përfituar nga bashkëpunimet ndërkombëtare të institucionit. Në këtë kuadër, Qendra e Inovacionit (INNOV8), e krijuar nga UNIKO në vitin 2018, luan një rol kyç në mbështetje të këtyre trajnimeve. Projekti "Innovation Eco-System in the CBC area (CBC INNOV8)" ka forcuar lidhjen midis universitetit dhe biznesit dhe ka mundësuar zhvillimin e trajnimeve me fokus të veçantë në inovacion dhe menaxhim, përfshirë menaxhimin e bizneseve turistike dhe destinacioneve turistike. Pjesëmarrës në këto trajnime kanë qenë studentë aktivë, të diplomuar, përfaqësues të bizneseve dhe autoriteteve lokale, duke garantuar që përvoja e fituar nga këto aktivitete profesionale të jetë në përputhje me nevojat dhe zhvillimet e tregut të punës. <u>Referenca:</u> <i>Tabela përmbledhese MTAE</i> <i>Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marrëveshje bashkëpunimi të FE dhe DMT</i>
Konkluzione	GVJ shprehet se UNIKO ka kapacitetet dhe burimet e nevojshme për ofrimin e një programi studimi cilësor në fushën e turizmit dhe menaxhimit të eventeve. Programi është i përshtatshëm me kërkesat

	kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, bashkëpunimi i ngushtë me punëdhënësit dhe partnerët ndërkombëtarë siguron mundësi trajnimi të mëtejshme për studentët e diplomuar, duke u mundësuar atyre që të jenë të përgatitur për sfidat e tregut të punës dhe zhvillimet globale në fushën e turizmit dhe menaxhimit të eventeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni ka krijuar një strukturë të qartë dhe funksionale për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Marrëdhëniet brenda institucionit janë të organizuara në mënyrë që secila njësi dhe personeli të kenë detyra të qarta dhe përgjegjësi të mirë përcaktuara. Institucioni siguron bashkëpunim të frytshëm ndërmjet njësive dhe personelit përmes ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiwe, duke i mundësuar një mbikëqyrje të vazhdueshme dhe analizë të punës së tyre. Kjo ndarje detyrash dhe përgjegjësiwe siguron një përfshirje efektive të aktorëve kyç dhe kontribuon në një proces efikas dhe të organizuar. Kjo strukturë e organizuar lejon monitorimin e përparimit të programit, identifikimin e mundësive për përmirësim dhe siguron që programi të ofrohet në përputhje me standardet më të larta akademike dhe kërkesat e tregut të punës. <u>Referenca:</u> <i>Tabela permbledhese MTAE</i> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me	GVJ konstaton se UNIKO ka vendosur marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të biznesit vendas dhe ndërkombëtar për të realizuar objektivat e procesit mësimor dhe formimin e studentëve. Ky bashkëpunim është i integruar në kuadër të programit Erasmus+,

institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	duke mundësuar shkëmbime të suksesshme të stafit dhe studentëve me universitete partnere në Europë. Pjesëmarrja e anëtarëve të Departamentit të Menaxhimit të Turizmit në mësimdhënie në universitete jashtë vendit është një shembull i këtij bashkëpunimi ndërkombëtar, i cili pasuron përvojën akademike dhe praktike të studentëve. Gjithashtu, universiteti bashkëpunon me biznese lokale dhe ndërkombëtare, duke krijuar mundësi për praktikë profesionale dhe lidhje të drejtpërdrejta me industrinë, të cilat ndihmojnë në përgatitjen e studentëve për karrierën e tyre. Këto marrëdhënie sigurojnë që formimi i studentëve në fushën e turizmit të jetë në përputhje me kërkesat e tregut dhe trendeve globale, duke zhvilluar kompetenca menaxheriale dhe përgatitjen e tyre për një karrierë të suksesshme në këtë sektor dinamik. <u>Referenca:</u> <i>Tabela permbledhese MTAE</i> <i>Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marrëveshje bashkëpunimi te FE dhe DMT</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	UNIKO siguron realizimin e suksesshëm të programit të studimit përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të posaçme me institucione, institute kërkimore dhe kompani të fushave përkatëse, të cilat kanë për qëllim zhvillimin e praktikave profesionale dhe formave të tjera të përfshirjes praktike të studentëve. Këto marrëveshje ofrojnë mundësi të shumta për studentët për t'u përfshirë në aktivitete profesionale dhe për t'u përgatitur për kërkesat e tregut të punës. Për realizimin e praktikave profesionale, universiteti bashkëpunon ngushtë me punëdhënësit lokalë dhe ndërkombëtarë, duke krijuar një rrjet të gjerë partnerësh që sigurojnë mundësi praktike dhe mbikëqyrje profesionale. Përveç kësaj, mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve është një pjesë integrale e këtij bashkëpunimi dhe realizohet përmes programeve si Erasmus+ dhe marrëveshjeve me universitete dhe institute kërkimore ndërkombëtare. Këto mobilitete jo vetëm që nxisin zhvillimin akademik dhe kërkimor, por gjithashtu ndihmojnë në zgjerimin e mundësive për kërkime shkencore dhe përvojë ndërkombëtare, duke kontribuar në zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit akademik. <u>Referenca:</u> <i>Tabela permbledhese MTAE</i>

	<i>Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marrëveshje bashkepunimi te FE dhe DMT</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe informacionit të siguruar, GVJ konstaton se Departamenti i Menaxhimit të Turizmit (DMT), si njësia përgjegjëse për Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve në UNIKO, harton në mënyrë periodike raporte analitike që vlerësojnë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Këto raporte përfshijnë një vlerësim të detajuar të efektivitetit të praktikave profesionale, mobilitetit akademik, dhe pjesëmarrjes në kërkime shkencore, duke analizuar ndikimin e këtyre aktiviteteve në formimin dhe zhvillimin profesional të studentëve. Raportet gjithashtu ndihmojnë në identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm, duke siguruar që marrëveshjet e bashkëpunimit të jenë të frytshme dhe të kontribuojnë në cilësinë e përgjithshme të programit. Përmes këtyre raporteve, universiteti monitoron dhe rishikon vazhdimisht ndikimin e partneriteteve me institucione kërkimore dhe punëdhënës, duke garantuar që këto marrëveshje përmbushin objektivat e programit dhe përgatisin studentët për sfidat dhe kërkesat e tregut të punës. <u>Referenca:</u> <i>Tabela permbledhese MTAE</i> <i>Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marrëveshje bashkepunimi te FE dhe DMT</i> <i>Shtojca 3.2 Raporte te analizes vjetore te DMT</i> <i>Shtojca 6.4 Analiza vjetore e veprimtarise se FE</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se, UNIKO ka krijuar një strukturë të fortë për realizimin e programit të studimit, e cila përfshin bashkëpunim të ngushtë me institucione, kompani dhe organizata të tjera, si dhe një monitorim të vazhdueshëm të ndikimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i> <i>Universiteti siguron mundësi praktike dhe profesionale për studentët, ndërkohë që raporte analitike periodike vlerësojnë përfitimet e këtyre marrëveshjeve dhe identifikojnë mundësi për përmirësim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	GVJ konstaton se Programi i Studimit është i organizuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ofron Diplomë Universitare Master Profesional dhe është i strukturuar me një total prej 60 kreditesh ECTS, përkatësisht në një vit akademik me kohë të plotë. Programi përfshin dhjetë lëndë të detyrueshme dhe një lëndë me zgjedhje, të cilat janë kategorizuar në lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe lëndë plotësuese që përfshijnë aftësitë komunikative dhe praktikat profesionale. Në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, programi siguron një plan mësimor të detajuar që përcakton orët mësimore brenda dhe jashtë auditorit, përfshirë leksionet, seminarët dhe orët e praktikës profesionale, duke mundësuar një përvojë mësimore të plotë dhe të orientuar drejt kërkesave të tregut të punës. Ky sistem mundëson mobilitetin e studentëve dhe njohjen ndërkombëtare të kualifikimeve, duke ofruar transparencë dhe llogaridhënie në lidhje me përmbajtjen dhe ngarkesën e programit. Veprimtaritë formuese përcaktohen konform VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, si në tabelën e mëposhtme: <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th><th>Përqindja</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Kategoria A - LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 5%-10% (kredite)</td><td>8%</td></tr> <tr> <td>Kategoria B - LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për</td><td>40%</td></tr> </tbody> </table>	Kategoria	Përqindja	Kategoria A - LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 5%-10% (kredite)	8%	Kategoria B - LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për	40%
Kategoria	Përqindja						
Kategoria A - LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 5%-10% (kredite)	8%						
Kategoria B - LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për	40%						

	disiplinën shkencore 30% - 40% (kredite)	
	Kategoria C - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTE GRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje 20%-30% (kredite)	30%
	Kategoria D - LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale 10% (kredite)	10%
	Kategoria E - DETYRIME PËRMBYLLËSE 10%- 20% (kredite)	12%
<u>Referenca:</u> Tabelat permebledhese (Tab. 9) Shtojca 2.4 Kuadri i veprimtarive formuese Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit Shtojca 1.33 Kurrikula e programit të studimit		
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky program studimi është projektuar për të zhvilluar aftësi dhe kompetenca të avancuara në menaxhimin e turizmit dhe eventeve. Programi ofron njohuri të përparuara në fusha kyçe si planifikimi i turizmit, menaxhimi i eventeve sportive, turizmi i qëndrueshëm, menaxhimi i atraksioneve turistike, marketingu digjital dhe menaxhimi i cilësisë totale në turizëm, mes të tjerash. Kurrikula e programit është e strukturuar në mënyrë që të ofrojë një kuptim kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, ndërsa zhvillon aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar si turizmi dhe menaxhimi i eventeve. Programi gjithashtu i mundëson studentëve të thellojnë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësi të avancuara, të cilat janë thelbësore për përgatitjen e tyre për një karrierë profesionale dhe menaxheriale në sektorë dinamike dhe të kërkuara si turizmi dhe menaxhimi i eventeve. <u>Referenca:</u> Shtojca 2.4 Kuadri i veprimtarive formuese Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit Shtojca 1.33 Kurrikula e programit të studimit	

Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Pas shqyrtimit të informacionit, GVJ konstaton se Programi i Studimit të Ciklit të Dytë në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Lënda e praktikës profesionale është e përcaktuar në semestrin e II dhe realizohet me 3 kredite ECTS. Po ashtu, detyrimet përmbyllëse, përfshirë mbrojtjen e temës së diplomës, janë të përcaktuara me 7 kredite ECTS dhe realizohen sipas udhëzuesit të përgatitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës. Kjo strukturë siguron që studentët të kenë një mundësi të qartë dhe të organizuar për të përfunduar praktikën profesionale dhe për të përmbushur detyrimet e diplomës, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të tyre profesionale. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Shtojca 1.33 Kurrikula e programit të studimit</i> <i>Shtojca 1.45 Udhëzuesi i praktikës profesionale</i> <i>Shtojca 2.3 Udhëzues për punimin e diplomës</i> <i>Shtojca 2.4 Kuadri i veprimtarive formuese</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm	Nuk aplikohet

psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve i ofruar nga departamenti DMT i FE të UNIKO ka një përmbajtje të ngjashme me programet e tjera të ciklit të dytë në të njëjtën fushë studimi, të ofruara nga universitete të ndryshme në Shqipëri. Përmbajtja e tij është e ngjashme dhe përputhet në një nivel të kënaqshëm me programet e tjera të ofruara në të njëjtën fushë. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.15 Kodifikimi i programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.12 Programe te ngjashme MTAE</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ konstaton se Programi i Studimit është i pajisur me kodin përkatës sipas fushës së studimit, në përputhje me klasifikimet dhe udhëzimet e publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Programi i studimit është pajisur përkatësisht me kodin 71MP1015S duke ju përmbajtur Udhëzimit Nr.31 datë 15.11.2022 “Kodifikimi i programeve të studimit”. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.15 Kodifikimi i programit të studimit</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta	Nuk aplikohet

midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se, Programi i Studimit është në përputhje me kërkesat ligjore dhe akredituese. Programi ka një strukturë të qartë dhe të organizuar, me përmbajtje të ngjashme me programet e tjera të fushës në Shqipëri, dhe është i kodifikuar sipas klasifikimeve të Ministrisë së Arsimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	GVJ konstaton se, Njësia kryesore përgjegjëse dhe ajo bazë për Programin e Studimit të përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Ajo ka një strukturë akademike të mirëpërcaktuar, e cila siguron një organizim të qartë dhe funksional të programit. Staf i akademik është i kualifikuar dhe i përshtatshëm për programin, dhe proceset e vlerësimit dhe akreditimit janë të realizuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet përkatëse. FE përbëhet nga 31 anëtarë të personelit akademik, nga të cilët: • 14 profesorë të asociuar, • 15 doktorë shkencash • 2 doktorantë Përsa i përket njësisë bazë, ajo përbëhet vetm nga staf i brendshëm dhe përbërja për dy vitet e fundit është 9 PAE, ku 5 Prof. AS dhe 4 Dr, dhe 0 PAK. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.37 Personeli akademik dhe ndihmës akademik i FE</i> <i>Shtojca 1.38 Të dhëna për personelin Akademik i DMT</i> <i>Shtojca 2.14 CV-të e stafit ndihmës akademik</i>

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, DMT ka një staf akademik të kualifikuar dhe të strukturuar, përbërë nga 9 anëtarë, ku 5 janë me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 4 me gradën "Doktor". Po ashtu, Njësia mbështetet nga staf ndihmës akademik dhe administrativ të Fakultetit, i cili kontribuon në realizimin e praktikave mësimore dhe mbështetjen administrative të programit.			
	<u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.37 Personeli akademik dhe ndihmës akademik i FE</i> <i>Shtojca 1.38 Të dhëna për personelin Akademik i DMT</i> <i>Shtojca 2.14 CV-të e stafit ndihmës akademik</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia kryesore përgjegjëse për Programin e Studimit ka caktuar një Koordinator të Programit, i cili luan një rol kyç në drejtimin dhe zhvillimin e programit. Koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe për zhvillimin e praktikave profesionale, duke u siguruar që ato përputhen me objektivat e programit. Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e DMT dhe ka një bashkëpunim të ngushtë me Drejtuesin e Departamentit për të siguruar menaxhimin efikas dhe përparimin e programit.			
	<u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 2.8 Koordinator i programit të studimit</i> <i>Shtojca 1.46 Rregullore e DMT</i> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se, Programi i studimit ka një strukturë të qartë dhe të mirëpërcaktuar, ku stafi akademik dhe ndihmës akademik mbështet realizimin e praktikave mësimore dhe administrativet. Koordinator i programit ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe zhvillimin e programit, duke siguruar përputhshmëri me objektivat e tij dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	DMT disponon informacionet e plota dhe të nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e Programit të Studimit. Ky informacion është i mbështetur në dokumente të rëndësishme, përfshirë Statutin e UNIKO, Rregulloren e UNIKO, Rregulloren e brendshme të FE dhe DMT, Rregulloren e Programit të Studimit, si dhe Planin mësimor të Programit dhe programet lëndore. Po ashtu, DMT ka përcaktuar kuotat e pranimit dhe kriteret përkatëse, të cilat janë të dokumentuara në rregulloren përkatëse të programit të studimit. Ky informacion siguron një organizim të strukturuar dhe transparent për të gjithë përfshirësit në procesin arsimor. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullore UNIKO</i> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit</i> <i>Shtojca 1.34 Rregullore e FE</i> <i>Shtojca 1.46 Rregullore e DMT</i> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.11 Kuotat e pranimit në programet e studimit të DMT</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ konstaton se, Programi i Studimit përmban një plan mësimor të detajuar, i cili ofron informacion të plotë për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, si dhe orët në auditor dhe jashtë auditorit. Plani mësimor përfshin elementë të rëndësishëm si struktura javore, modulet e programit të studimit, lëndët e detyruara dhe të zgjedhura, numrin e krediteve të çdo moduli, ndarjen e orëve për leksione, seminare, ushtrime dhe laboratorë, si dhe periudhën dhe mënyrën e kontrollit të dijeve për çdo modul. Plani mësimor i programit përmban përkatësisht 600 ore mësimore në auditor dhe 900 orë jashtë auditorit, me një total 1500 orë. Ky plan përditësohet çdo vit akademik dhe miratohet nga Senati i UNIKO, duke u bërë i disponueshëm për studentët që në fillim të studimeve, si dhe duke u publikuar në mënyrë të aksesueshme për të gjithë përfshirësit në program. <u>Referenca:</u> <i>Tabelat përmbledhese</i> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i>

Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Bazuar në aktet rregullatore të mundësuar nga institucioni, vihet re se Programi i Studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto kriteret janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit dhe janë të aksesueshme për studentët. Informacioni për kriteret e pranimit, si dhe për procedurat dhe kushte për transferimin dhe ekuivalentimin e krediteve të studimeve, është i qartë dhe transparent, duke siguruar që studentët të kenë një kuptim të plotë mbi mundësitë dhe kërkesat që lidhen me këto procese. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset për secilën lëndë, përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm duke përfshirë praktikant, seminarin, orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Syllabuset janë të detajuara dhe përputhen me formatet e miratuara, duke specifikuar qartë përmbajtjen, objektivat, metodat mësimore dhe mënyrat e vlerësimit për çdo lëndë. Ky informacion është i disponueshëm dhe i aksesueshëm për studentët, duke siguruar një planifikim të qartë dhe të strukturuar për zhvillimin e procesit mësimor dhe praktikant profesionale. Megjithatë, në një pjesë të konsiderueshme syllabusesh, në literaturën e cituar nuk specifikohen vitet e botimit të literaturës bazë dhe asaj të detyrueshme. Në disa raste, kjo literaturë nuk është përditësuar. <u>GVJ rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës, pasi për shumë lëndë raportohet se literatura është e pa përditësuar, veçanërisht ajo e literaturës së rekomanduar.</u> <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.32 Programet lëndore</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen	GVJ konstaton se, Programi i Studimit është në proces të përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm. Çdo vit akademik, ndryshimet eventuale të programit miratohen nga Senati i UNIKO dhe dokumentohen. Analiza e të dhënave nga raportet e vlerësimit të NJSBC shfrytëzohen për rishikimin e kurrikulës, planit mësimor, programeve të lëndëve dhe përditësimin e dokumentacionit me

ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	njohuri bashkëkohore. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.10 Ndryshimet ne planet mesimore MTAE</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se, Programi i Studimit është i strukturuar në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe ofron informacion të plotë për lëndët, praktikën, ngarkesën mësimore dhe procedurat e pranimit. Programi përditësohet çdo vit akademik dhe ndryshimet miratohen dhe dokumentohen, duke siguruar cilësi dhe transparencë. Megjithatë, vihet re mungesë e përditësimit të literaturës së 5 viteve të fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstaton se, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave në këtë Program Studimi janë të strukturuar në mënyrë që të mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për studentët, duke i përgatitur ata për studime të mëtejshme dhe përpunësim në sektorët e turizmit dhe menaxhimit të eventeve. Programi ofron mundësi për zhvillim të aftësive profesionale dhe praktike, që janë të rëndësishme për kërkesat e tregut të punës dhe për avancimin e karrierës. Bazuar në tabelën nr. 23, të gjithë të diplomuarit janë punësuar në përfundim të studimeve dhe përqindje shumë e lartë është në marrëdhënie pune në përputhje me diplomën, kjo edhe falë marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe kompani të fushës së studimit. <u>Referenca:</u> <i>Tabelat përmbledhese</i> <i>Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marrëveshje bashkëpunimi të FE dhe DMT</i>

Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ vëren se kurrikula e Programit të Studimit është hartuar në përputhje me profilin e programit dhe objektivat formues të tij. Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve në semestra është e strukturuar në mënyrë që të mundësojë zhvillimin e kompetencave profesionale dhe specifike për studentët. Lëndët mbulojnë një gamë të gjerë tematikash, nga menaxhimi i destinacioneve turistike dhe eventeve sportive, deri tek menaxhimi i cilësisë totale në turizëm, duke siguruar arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Angazhimi në këtë program ofron një mundësi të qartë për zhvillimin e aftësive dhe njohurive të nevojshme për një karrierë të suksesshme në industrinë e turizmit dhe menaxhimit të eventeve. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.32 Programet lendore</i> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Kurrikula e programit të Studimit është e përputhshme me profilin e programit dhe siguron një balancë të mirë midis teorisë dhe praktikës. Lëndët janë të dizajnuara për të ofruar aftësi dhe kompetenca të thelluara profesionale në fushën e menaxhimit të turizmit dhe eventeve, duke përfshirë aspekte si menaxhimi i destinacioneve, turizmi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i projekteve. Ky program është i përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare, duke siguruar një formim të thelluar dhe përgatitje profesionale për studentët, për t'u integruar me sukses në tregun e punës. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Shtojca 2.12 Programe te ngjashme MTAE</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja e veprimtarive formuese në Programin e është e strukturuar në mënyrë të tillë që të mundësojë arritjen e objektivave formues të programit. Raporti mes formimit teorik dhe praktik është i balancuar, duke siguruar që studentët të zhvillojnë aftësi praktike dhe të thella teorike në fushën e turizmit dhe menaxhimit të eventeve. Plani mësimor i programit përmban përkatësisht 600 ore mësimore në auditor dhe 900 orë jashtë auditorit, me një total 1500 orë. Kjo qasje e strukturuar rrit mundësitë për punësim pas përfundimit të studimeve, duke i përgatitur studentët për sfidat dhe kërkesat e tregut të punës.

	Kategoria	Përqindja
	Kategoria A - LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 5%-10% (kredite)	8%
	Kategoria B - LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore 30% - 40% (kredite)	40%
	Kategoria C - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTE GRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje 20%-30% (kredite)	30%
	Kategoria D - LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale 10% (kredite)	10%
	Kategoria E - DETYRIME PËRMBYLLËSE 10%- 20% (kredite)	12%
<u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i>		
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve dhe moduleve në Programin e Studimit përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke siguruar që përmbajtja e tyre të mbështesë zhvillimin e kompetencave të nevojshme për tregun e punës. Bibliotekat digjitale ofrojnë akses në EBSCO, Publishing Databases, ku stafi akademik dhe studentët mund të regjistrohen, të përdorin dhe të shkarkojnë revista, periodikë, libra, artikuj, etj. <i>Por, në përditësimin e syllabuseve rekomandohet edhe përfshirja e literaturës së fundit për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse.</i> <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.12 Programe te ngjashme MTAE</i> <i>Shtojca 3.5 Biblioteka</i>	
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e Programit të Studimit është e strukturuar për të garantuar përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për studentët. Lëndët dhe praktikat profesionale janë të dizajnuara në mënyrë që të zhvillojnë njohuritë teorike dhe ato praktike të nevojshme për sektorin e turizmit dhe menaxhimit të eventeve. Ky	

	program siguron që studentët të jenë të pajisur me kompetencat e kërkuara për të qenë të suksesshëm në fushën profesionale, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive që i ndihmojnë ata të përballen me sfidat e tregut të punës. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	GVJ konstaton se përmbajtja e Programit të Studimit është e strukturuar në mënyrë që të mundësojë vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve, në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e tregut të punës. Programi ofron një kombinim të teorisë dhe praktikës që përgatit studentët për sfidat e industrisë së turizmit dhe menaxhimit të eventeve, duke i mundësuar atyre të zhvillojnë aftësi të thelluara dhe të aplikueshme në karrierën e tyre. Kjo qasje siguron një kalim të lehtë dhe të suksesshëm në tregun e punës pas përfundimit të studimeve. <u>Referenca:</u> <i>Tabelat përmbledhese</i> <i>Shtojca 1.41 Marreveshje institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marreveshje bashkepunimi të FE dhe DMT</i> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se, Programi i Studimit është i strukturuar dhe dizajnuar në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe mundëson zhvillimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të nevojshme për studentët. Ky program ofron mundësi për integrimin e suksesshëm të studentëve në tregun e punës, duke u përgatitur ata për sfidat dhe kërkesat e industrisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen	GVJ konstaton se Programi i Studimit është zhvilluar dhe përmirësuar në përputhje me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Departamenti MKT ka realizuar studime të detajuara të tregut për të

sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	vlerësuar nevojat dhe pritshmëritë e punëdhënësve, studentëve dhe të diplomuarve, duke përfshirë bashkëpunimin me partnerët institucionalë dhe aktorët e tregut. Ky proces konsultimi ka kontribuar në përshtatjen e programit dhe moduleve të tij për të siguruar që studenti të ketë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u integruar me sukses në tregun e punës. Rrjeti Alumni dhe diskutimet në tryeza të rumbullakta gjithashtu ofrojnë mundësi për përditësimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të programit. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 3.2 Raporte te analizes vjetore te DMT</i> <i>Shtojca 1.30 Analiza e QKA</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	UNIKO, përmes Departamentit MKT, ka krijuar një mjedis të hapur dhe bashkëpunues për përmirësimin e vazhdueshëm të Programit të Studimit. Institucioni angazhon studentët dhe strukturat e tyre në diskutime të rregullta dhe përfshin studentët e diplomuar përmes rrjetit Alumni, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme për të vlerësuar dhe pasqyruar nevojat dhe përvojat e tyre. Ky proces ndihmon në reflektimin e sugjerimeve të studentëve dhe të diplomuarve, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe përshtatjen e programit të studimit me kërkesat dhe zhvillimet e tregut të punës. UNIKO garanton të drejtën e studentëve për t'u përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësim të procesit akademik, përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Studentët në UNIKO organizohen në Këshilla Studentore në nivelin e njëjësive kryesore dhe të institucioneve. Këshilli Studentor i Fakultetit promovon dhe koordinon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese të UNIKO, në strukturat mësimore-kërkimore dhe ato të shërbimeve. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 1.17 Rregullorja e këshillit studentor</i> <i>Shtojca 1.30 Analiza e QKA</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në	GVJ konstaton se Departamenti MKT i UNIKO ka një qasje të strukturuar dhe të përhershme për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Ky proces përfshin marrjen parasysh të zhvillimeve të fundit në industrinë e turizmit dhe mikpritjes, përfundimeve nga tryezat e rumbullakëta me ekspertë të sektorëve privat dhe shtetëror, si dhe studime të tregut të punës. Gjithashtu,

bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	përfshirja e stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare, si konferenca dhe trajnimet nga fondacioni "La fondation pour la formation Hoteliere," ka kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të programit.			
	<u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.36 Vendimi i riorganizimit të MTAE</i> <i>Shtojca 2.10 Ndryshimet ne planet mesimore MTAE</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se, Departamenti ka një proces të rregullt dhe të strukturuar për përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit. Pjesëmarrja aktive e stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare, si konferenca dhe trajnime, ka kontribuar në përditësimin dhe përmirësimin e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor. Këto objektiva janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat madhorë të institucionit, të cilat përfshijnë zhvillimin e aftësive profesionale dhe kërkimore të studentëve në fushën e turizmit dhe menaxhimit të eventeve, si dhe kontribuimin në zhvillimin e sektorit të turizmit dhe mikpritjes. Programi fokusohet në forcimin e lidhjes midis teorisë dhe praktikës, duke përgatitur studentët për sfidat e tregut të punës dhe kërkesat e industrisë. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike	FE dhe DMT si njësi kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit nxisin dhe bashkërendojnë me efikasitet veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Të dyja njësitë në bashkëpunim të vazhdueshëm krijojnë një ambient akademik ku respektohet liria akademike e personelit dhe veçoritë e fushës së studimit, duke lejuar që çdo anëtar i stafit të zhvillojë dhe ofrojë mësim dhe kërkim në përputhje me standardet e larta akademike.

të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Kjo strukturë promovon një balancë mes aktiviteteve mësimore dhe kërkimore, duke garantuar një përvojë të integruar dhe të plotë për studentët. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit nxit dhe motivon studentët të angazhohen në projekte dhe aktivitete kërkimore. Kjo arrihet përmes mundësive që ofrohen studentëve për të marrë pjesë në struktura që sigurojnë cilësinë, si Senati Akademik dhe Këshilli i Etikës, dhe përmes angazhimit të tyre në takime, sondazhe dhe pyetësorë që ofrojnë mundësi për zhvillimin e projekteve kërkimore. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm dhe mbështetjes financiare dhe logjistike nga UNIKO, studentët kanë mundësi të zhvillojnë ide inovative dhe të paraqesin punimet e tyre në konferenca rajonale dhe ndërkombëtare, duke kontribuar kështu në kërkimin shkencor dhe avancimin e dijes. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 1.23 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e drejtorisë së projekteve dhe kërkimit shkencor</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Programi i studimit në UNIKO mbështetet financiarisht për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore, duke siguruar burime të mjaftueshme nga institucioni. UNIKO siguron fonde të posaçme për mbështetjen e projekteve kërkimore, zhvillimin e projekteve studentore dhe organizimin e aktiviteteve shkencore si konferenca, seminare dhe workshop-e. Kjo mbështetje përfshin alokimin e fondeve për realizimin e projekteve kërkimore, aktiviteteve të zhvillimit akademik dhe pjesëmarrjen në konferenca. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 4.11 Fondet dhe të ardhurat UNIKO</i> <i>Shtojca 1.43 Aktivitetet e DMT</i>
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se, se programi i studimit ofron një strukturë të fortë dhe të mirëfinancuar për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore.</i> <i>Njësi bazë ka mbështetje të qëndrueshme financiare nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme, duke mundësuar zhvillimin e projekteve dhe kërkimeve të avancuara.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Njësia përgjegjëse në UNIKO mbështet zhvillimin dhe avancimin e grupeve lëndore dhe projekteve kërkimore-shkencore, duke inkurajuar dhe siguruar mundësi financimi dhe burime për projektet e reja që kontribuojnë në objektivat e programit të studimit. Për këtë qëllim, institucionin ka krijuar një infrastrukturë të përshtatshme që mbështet kërkimin shkencor në të gjitha nivelet. Njësia gjithashtu inkurajon bashkëpunimin me struktura kërkimore të brendshme dhe ndërkombëtare, duke ndihmuar në lidhjen e grupeve kërkimore me institucione dhe laboratore të tjerë. Ky bashkëpunim mundëson shkëmbimin e përvojave dhe njohurive, si dhe realizimin e projekteve kërkimore të nivelit të lartë që kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor dhe të arritjeve akademike në programin e studimit. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 3.7 Projekte të fituara nga AKSHI</i> <i>Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësia përgjegjëse në UNIKO është e angazhuar në mënyrë aktive për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime dhe projekte me karakter kërkimor shkencor, duke ofruar mbështetje dhe burime të nevojshme për realizimin e këtyre aktiviteteve. Për realizimin e këtyre objektivave, njësia përfshin personelin akademik dhe studentët, të cilët kontribuojnë me njohuritë dhe ekspertizën e tyre për realizimin e projekteve kërkimore. Ky angazhim përfshin gjithashtu mundësinë për zhvillimin e mundësive praktike dhe përfshirjen aktive të studentëve në hulumtime shkencore, duke i angazhuar ata në projekte kërkimore dhe duke u ofruar mundësi për zhvillim profesional. Personeli akademik dhe studentët bashkëpunojnë për të krijuar një mjedis kërkimor që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së studimeve dhe kërkimit shkencor, si dhe në arritjen e rezultateve të rëndësishme në fushat e studimit dhe kërkimit shkencor.

	<u>Referenca:</u> <i>Shtojca 3.7 Projekte të fituara nga AKSHI</i> <i>Shtojca 1.43 Aktivitetet e DMT</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Nga evidencat shoqëruese të RVB dhe takimeve me personelin dhe atudentët, GVJ konstaton se, Njësia përgjegjëse për Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve (DMT) organizon rregullisht konferenca dhe aktivitete profesionale që mbështesin zhvillimin e personelit akademik dhe studentëve në arritjen e objektivave të tyre akademike dhe kërkimore. Aktivitetet janë të fokusuar në tema kyçe për fushën e turizmit dhe adresojnë sfidat aktuale të këtij sektori. Konferencat dhe seminarët ofrojnë mundësi për shkëmbimin e ideve dhe rezultateve kërkimore mes studentëve, pedagogëve dhe profesionistëve të industrisë, duke inkurajuar bashkëpunime të reja dhe zhvillim profesional. Pjesëmarrja aktive e personelit dhe studentëve në këto aktivitete kontribuon në përmbushjen e objektivave akademike dhe nxit angazhimin e tyre në zhvillimin e ideve të reja dhe projekteve kërkimore, duke forcuar lidhjen mes teorisë dhe praktikës në fushën e turizmit. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.43 Aktivitetet e DMT</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit ofron një përgatitje të thelluar dhe të plotë për studentët, duke i pajisur ata me njohuri dhe aftësi të nevojshme për të qenë profesionistë konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Ky program fokusohet në zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike që lidhen me menaxhimin e turizmit, atraksioneve dhe eventeve, duke përgatitur studentët për sfidat dhe mundësitë e këtij sektori global. Pjesëmarrësit e programit fitojnë një kuptim të thellë të trendeve të fundit në turizëm dhe zhvillimin e atraksioneve dhe eventeve, duke i mundësuar atyre të adaptohen dhe të konkurruar me sukses në tregun e punës, si në nivel kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar. Kjo përgatitje i bën ata të gatshëm për pozita të ndryshme menaxheriale dhe strategjike në industri të ndryshme të turizmit, duke i siguruar një avantazh konkurrues në tregun e punës. <u>Referenca:</u>

	<i>Tabelat përmbledhese</i> <i>Shtojca 1.41 Marreveshje institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marreveshje bashkepunimi te FE dhe DMT</i> <i>Shtojca 1.45 Udhezues per pergatitjen dhe mrojtjen e praktikës</i> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrejetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk Aplikohet			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Nuk Aplikohet			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se, programi i studimit ofron një strukturë të fortë dhe mbështetje financiare të qëndrueshme, duke mundësuar zhvillimin e aktiviteteve studimore dhe kërkimore. Ai për gatit studentët për të qenë profesionistë konkurrues në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, duke i pajisur ata me aftësi praktike dhe teorike të avancuara. Aktivitetet e ndryshme akademike dhe kërkimore kontribuojnë në përmbushjen e objektivave akademike dhe zhvillimin e karrierës profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit ofron një gamë të gjerë formash të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përfshirë leksione, seminare, detyra kursi, projekte dhe praktika profesionale. Këto metoda përdoren për të siguruar një përvojë mësimore të pasur dhe të larmishme që inkurajon zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike të studentëve. Praktikët profesionale ofrojnë mundësi për aplikimin e njohurive në situata reale, ndërsa orët e hapura ofrojnë mundësi për diskutime dhe shkëmbim ideje midis studentëve dhe pedagogëve. Kjo qasje e shumëllojshme ndihmon në përgatitjen e studentëve për sfidat dhe kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë aspekte të ndryshme të fushës së turizmit dhe menaxhimit të eventeve. <u>Referenca:</u> <i>Tabelat përmbledhese</i> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ofron forma dhe metoda të ndryshme mësimdhënieje dhe mësimnxënies. Ata përdorin qasje të larmishme, si leksione interaktive, seminare, punë grupore, projekte dhe praktika profesionale, për të siguruar një mjedis mësimor të përshtatshëm për të gjithë studentët. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.1 Plani mësimor i programit të studimit</i> <i>Shtojca 1.43 Aktivitetet e DMT</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UNIKO ofron mbështetje të vazhdueshme për personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes trajnimeve dhe mundësive për shkëmbime eksperiencash me universitete të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Personeli akademik i DMT është i përfshirë në mobilitete ndërkombëtare, duke përfituar nga programet si Erasmus+ dhe marrëveshjet me

	universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare. Këto mundësi zhvillojnë aftësitë akademike dhe kërkimore të stafit, duke i mundësuar atyre përvojë ndërkombëtare dhe mundësi për kërkime shkencore. Angazhimi në këto programe dhe bashkëpunime ndërkombëtare ndihmon në përmirësimin e metodave didaktike dhe siguron që praktikatat e mësimdhënies të jenë të përputhshme me rezultatet e pritshme të të nxënës. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.43 Aktivitetet e DMT</i> <i>Shtojca 3.8 Mobilitete të stafit të DMT</i>																																		
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit është i kualifikuar në këtë fushë studimi, dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në Departamentin e për periudhën 2023-2025 është si më poshtë: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2023 - 2024</th><th colspan="2">2024 - 2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE:</th><th>PAK:</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>6</td><td>-</td><td>5</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Në total</td><td>10</td><td>-</td><td>9</td><td>-</td></tr></table> Gjithashtu, GJV konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij. Në këtë mënyrë, ata krijojnë një mjedis mësimor ku studentët janë në qendër të procesit, duke inkurajuar diskutime të hapura që nxisin mendimin krijues dhe kritik, duke i përgatitur ata për sfida profesionale dhe akademike. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i>	Tituj/grada	2023 - 2024		2024 - 2025		PAE	PAK	PAE:	PAK:	Prof.Dr	1	-	1	-	Prof.As.Dr	6	-	5	-	Dr/PhD	3	-	3	-	Msc	-	-	-	-	Në total	10	-	9	-
Tituj/grada	2023 - 2024		2024 - 2025																																
	PAE	PAK	PAE:	PAK:																															
Prof.Dr	1	-	1	-																															
Prof.As.Dr	6	-	5	-																															
Dr/PhD	3	-	3	-																															
Msc	-	-	-	-																															
Në total	10	-	9	-																															

	<i>Tabelat përmbledhëse MTAE</i> <i>Shtojca 4.8 Kualifikimet e stafit akademik të FE</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia përgjegjëse për ofrimin e Programit të Studimit në UNIKO ka një qasje të vazhdueshme për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies, duke realizuar rishikime periodike të praktikave të përdorura. Ky proces përfshin studentët, të cilët jepen mundësi për të shprehur mendimet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me format dhe metodat e mësimdhënies nëpërmjet organizimit të pyetësorit studentor, si dhe pyetësorit të përgatitur nga vetë pedagogu në përfundim të modulit/lëndës. Përmes anketimeve dhe diskutimeve, mendimet e studentëve merren parasysh dhe përdoren për të përmirësuar përvojën mësimore, duke siguruar që metodat e mësimdhënies të jenë gjithmonë në përputhje me nevojat e studentëve dhe standardet akademike. Ky angazhim për përmirësim të vazhdueshëm kontribuon në cilësinë dhe efektivitetin e programit. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Tabelat përmbledhëse MTAE (Tab. 11)</i> <i>Shtojca 2.10 Ndryshimet në planet mësimore MTAE.</i> <i>Shtojca 3.1 Modeli dhe raporti i pyetësorit studentor</i> <i>Shtojca 2.16 Model pyetësori fund kursi</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht	UNIKO ka struktura dhe njësi të dedikuara që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe sigurojnë koordinimin e aktiviteteve për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në nivel institucional. Në UNIKO është ngritur Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional. Brenda saj funksionon Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë me përfaqësues një koordinator nga çdo njësi kryesore. Këto njësi punojnë ngushtë me njësitë kryesore për të zhvilluar dhe zbatuar metoda inovative të mësimdhënies, duke inkurajuar eksperimentimin dhe aplikimin e praktikave të reja. Raportet e vlerësimit të NJSBC, shërbejnë si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca 1.44 Struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë uniko</i>

personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Shtojca A 3.1 Modeli i pyetësorit dhe raportit studentor Shtojca 6.1 Njësia e Brendëshme e Sigurimit të Cilësisë të FE			
Konkluzione	GVJ shprehet se, UNIKO siguron një mbështetje të qëndrueshme dhe inovative për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke inkurajuar përdorimin e metodave të reja dhe interaktive. Strukturat dhe njësitë përkatëse mbështesin një koordinim të efektshëm dhe bashkëpunim mes njësive kryesore për përmirësimin e mësimdhënies, duke i mundur stafit të zhvillojë aftësi të avancuara dhe të përmbushë nevojat e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në UNIKO, kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit dhe Rregulloren e Fakultetit. Këto kritere bëhen të disponueshme dhe publike për studentët në mënyrë që ata të kenë qasje të plotë në informacionin mbi metodat e vlerësimit dhe kërkesat përkatëse. Kjo siguron transparencë dhe bën të mundur që studentët të kenë një kuptim të qartë të pritshmërive dhe procedurave të vlerësimit gjatë gjithë programit të studimit. <u>Referenca:</u> Shtojca 1.34 Rregullore e FE Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit të zhvilluar me studentët për këtë program studimi, GVJ mori konfirmim nga vetë studentët që ata informohen në fillim të çdo lënde mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore, e cila është e detajuar në syllabuset përkatëse. Titullari i lëndës siguron që çdo student të ketë një kuptim të qartë të kritereve dhe metodave të vlerësimit përkatës, duke i mundur atij të jetë i përgatitur për provimet dhe detyrat

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	e kursit. Prezantimi i studentëve me syllabusin bëhet nga instruktori që në orën e parë të mësimet. <u>Referenca:</u> Takimi me studentët Shtojca 1.32 Programet lëndore			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Nga evidencat që disponon GVJ, testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma të ndryshme, të cilat përfshijnë provime, detyra kursi, projekte, prezantime dhe aktivitete të tjera praktike. Kjo qasje ofron mundësi për studentët të demonstrojnë jo vetëm njohuritë teorike, por edhe aftësitë praktike dhe kompetencat që ata kanë fituar gjatë programit të studimit. Forma të ndryshme vlerësimi sigurojnë që studentët të kenë mundësinë të tregojnë një gamë të gjerë aftësish, duke rritur kështu përvojën dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës. <u>Referenca:</u> Shtojca 1.34 Rregullore e FE Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit Shtojca 1.32 Programet lëndore			
Konkluzione	GVJ shprehet se, në përputhje me kriteret e lartpërmendura, UNIKO siguron transparencë dhe qartësi në procesin e testimit dhe vlerësimit të njohurive, duke përfshirë studentët në çdo hap të metodologjisë dhe kriterëve të vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e	Nga evidencat e vëna në dispozicion si dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se, testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohen gjatë vitit përmes formave të përcaktuara në syllabuset e lëndëve nga titullarët. Në fund të semestrit, vlerësimi bëhet nga komisionet e provimeve, të cilat përbëhen nga të paktën dy anëtarë, ku njëri është titullari i lëndës. Anëtarët e komisionit bëhen të njohur para sezonit të provimeve.

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i punimeve të diplomave realizohet nga një komision i posaçëm prej të paktën 3 pedagogësh, ku njëri është oponent. Komisioni vlerëson punimin pas prezantimit dhe merr parasysh mendimin e oponentit dhe udhëheqësit. Rezultatet regjistrohen dhe procesverbali firmoset nga anëtarët e komisionit. Vlerësimi i praktikës profesionale bëhet nga komisioni i vlerësimit të praktikës, i përbërë nga të paktën 3 anëtarë të departamentit, dhe merr parasysh vlerësimin e institucionit ku është kryer praktika. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO</i> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit</i> <i>Shtojca 1.34 Rregullore e FE</i> <i>Shtojca 3.6 Formatit dhe kriteret e vlerësimit të temës së diplomës</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga evidencat e vëna në dispozicion si dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se, UNIKO ka implementuar sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, në bashkëpunim me AADF dhe READ, për të parandalur abuzimet dhe për të rritur transparencën në procesin e vlerësimit. Përdorimi i platformës digjitale Clean Score mundëson realizimin e provimeve dhe vlerësimeve në mënyrë të automatizuar, duke garantuar anonimitetin dhe duke reduktuar mundësinë e ndërhyrjeve të jashtme ose parregullsive. Kjo qasje inovative siguron një proces të drejtë, të besueshëm dhe të bazuar në kriteret e qarta vlerësimi, duke përmirësuar cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve për çdo lëndë të programit. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.41 Marrëveshje Institucionale</i> <i>Shtojca 6.6 Raporti i implementimit të cleanscore</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Referuar dokumentacionit shoqërues të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se UNIKO siguron që vlerësimi përfundimtar i çdo lënde realizohet në përputhje të plotë me syllabusin dhe me bazën ligjore në fuqi. Kjo nënkupton se çdo kriter dhe metodë e vlerësimit, si dhe ndjekja e procedurave të përcaktuara, janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet akademike të aplikueshme, duke garantuar një proces të drejtë dhe të rregullt të vlerësimit për të gjithë studentët.

	Për këtë program studimi forma e kontrollit të njohurive është si më poshtë: <table border="1" data-bbox="758 248 1377 551"> <tr> <th colspan="2">Format e kontrollit të njohurive</th></tr> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td><td>5-10%</td></tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyra)</td><td>10-20%</td></tr> <tr> <td>Testimet gjatë vitit</td><td>10-20%</td></tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td><td>70%</td></tr> <tr> <td>Në total</td><td>100%</td></tr> </table> Ky informacion i bëhet i njohur studentit që në prezantimin e parë të orës mësimore. <u>Referenca:</u> RVB Tabelat përmbledhëse MTAE (Tab. 15) Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit Shtojca 1.32 Programet lëndore	Format e kontrollit të njohurive		Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	5-10%	Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyra)	10-20%	Testimet gjatë vitit	10-20%	Provimi përfundimtar	70%	Në total	100%
Format e kontrollit të njohurive													
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	5-10%												
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyra)	10-20%												
Testimet gjatë vitit	10-20%												
Provimi përfundimtar	70%												
Në total	100%												
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Bazuar në evidencat e vëna në dispoziicion si dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente dhe feedback konstruktiv, i cili ndihmon studentët të kuptojnë arritjet dhe fushat që kërkojnë përmirësim. Ky feedback lidhet ngushtë me këshilla mbi procesin e të nxënit, duke i ofruar studentëve udhëzime për të përmirësuar aftësitë dhe performancën e tyre në të ardhmen. Ky proces mbështet zhvillimin e studentëve dhe i mundëson atyre të rriten akademikisht dhe profesionalisht. Rezultatet e provimit regjistrohen në sistemin Pitagora, dhe studentët mund të ankimojnë rezultatin brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e Fakultetit. <u>Referenca:</u> Shtojca 1.34 Rregullore e FE												
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Bazuar në evidencat e vëna në dispoziicion, njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik angazhohen për të shmangur dhe parandaluar çdo formë plagjiature dhe kopjimi në provime dhe detyra. Institucioni ka vendosur masa të qarta dhe të rrepta për të monitoruar dhe zbatuar etikën akademike, duke siguruar një mjedis të drejtë dhe të ndershmë për të gjithë studentët.												

	Përdorimi i platformës digjitale Clean Score mundëson realizimin e provimeve dhe vlerësimeve në mënyrë të automatizuar, duke garantuar anonimitetin dhe duke reduktuar mundësinë e ndërhyrjeve të jashtme ose parregullsive. Përdorimi i sistemeve dhe teknologjive të avancuara për detektimin e plagjiaturës është një pjesë e rëndësishme e këtij angazhimi, duke siguruar që të gjitha detyrat dhe provimet të jenë autentike dhe të besueshme. Gjithashtu, Komisioni i provimit gjatë zhvillimit të provimit monitoron studentët për të shmangur plagjiaturën <u>Referenca:</u> Shtojca 1.34 Rregullore e FE Shtojca 6.6 Raporti i implementimit të cleanscore
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në rregulloren e Fakultetit, Kreu X, neni 84, pika 2, përcaktohet që rezultatet e provimit t'u bëhen me dije studentëve brenda 6 ditëve dhe më pas këto rezultate publikohen online edhe në sistemin e menaxhimit. Institucioni siguron që rezultatet e vlerësimit të jepen në kohë, duke respektuar afatet e përcaktuara dhe duke ndihmuar studentët të kenë një pasqyrë të qartë dhe të saktë të performancës së tyre akademike. <u>Referenca:</u> Shtojca 1.34 Rregullore e FE
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Bazuar në rregulloren e Fakultetit, UNIKO garanton të drejtat e studentëve për të qenë të informuar mbi vlerësimin e tyre dhe për të pasur mundësinë për të kërkuar rishikimin e vlerësimit në përputhje me rregullat e përcaktuara në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studenti duhet të bëjë një ankesë me shkrim jo më vonë se 8 ditë për provimet me shkrim, nga data e dhënies së tij. Kjo kërkesë i drejtohet Dekanit të FE. Ky proces mbështet drejtësinë dhe siguron që studentët të kenë mundësinë të mbrojnë të drejtat e tyre akademike në mënyrë të qartë dhe të rregullt. <u>Referenca:</u> Shtojca 1.34 Rregullore e FE
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm.	Sipas akteve rregullatore, institucioni siguron që çdo kërkesë ose ankimim të shqyrtohet Dekani i Fakultetit në bashkëpunim me komisionin e provimit, me praninë edhe të studentit. Procedura e ndjekur është e qartë dhe transparente për të gjitha palët e

Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	përfshira, duke garantuar një proces të drejtë dhe të dokumentuar dhe bën publik brenda 2 ditëve. Të gjitha procedurat dhe vendimet e lidhura me ankimimet janë të dokumentuara dhe të arkivuara në mënyrë të rregullt, për të siguruar një pasqyrë të qartë dhe të verifikueshme të procesit të vlerësimit dhe shqyrtimit të ankimimeve. Vendimi është i formës së prerë. Në rast miratimi nga Dekani përsa i përket ankimimit të vlerësimit, studentit i jepet e drejta e ridhënies së provimit me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. <u>Referenca:</u> Shtojca 1.34 Rregullore e FE			
Konkluzione	GVJ shprehet se, UNIKO garanton transparencë dhe drejtësi në procesin e vlerësimit dhe shqyrtimit të ankimeve, duke siguruar që çdo kërkesë të trajtohet në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara. Institucioni ofron mundësi për studentët që të njohin dhe të kërkojnë rishikime të vlerësimeve, duke siguruar një proces të qartë dhe të dokumentuar për të mbrojtur të drejtat e tyre akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se programi i studimit ofron mundësi të shumta për thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve. Ky program ka si synim zhvillimin e aftësive shkencore, praktike dhe profesionale të studentëve. Konkretisht gjatë procesit të mësimdhënies zbatohen metoda mësimdhënie me studentët si: raste studimi, ese, analizë kritike, detyra në mënyrë individuale dhe në grup. Ky program është i strukturuar në mënyrë që të ofrojë një bazë të fortë teorike, ndërkohë që integron praktika të avancuara që zhvillojnë aftësi specifike dhe kritike për fushën e studimit. Përmes aktiviteteve kërkimore, seminareve dhe praktikave profesionale, studentët mund të shfrytëzojnë mundësitë për të

	zgjeruar njohuritë e tyre dhe për të përmirësuar aftësitë profesionale të nevojshme për karrierën e tyre. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.33 Kurrikula e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se programi i studimit ofron mundësi për thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve. Gjatë procesit të mësimdhënies zbatohen metoda të ndryshme, si raste studimi, ese, analizë kritike, detyra individuale dhe në grup, duke nxitur angazhimin aktiv të studentëve. Programi është i strukturuar në mënyrë që të ofrojë një bazë të fortë teorike, ndërkohë që integron praktika të avancuara për zhvillimin e aftësive teknologjike, sociale dhe të komunikimit. Studentët janë të inkurajuar të zhvillojnë aftësi në gjuhë të huaj, kjo vjen në bashkëveprim të vazhdueshëm midis studentëve dhe profesionistëve të fushës në aktivitetet trajnuese. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 3.9 Relacion për bashkëpunimin me FH</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se programi i studimit ofron një strukturë të qartë për analizimin dhe shqyrtimin e kompetencave dhe aftësive që studentët fitojnë gjatë procesit mësimor. Ky program ka si synim të sigurojë që rezultatet e të nxënësve të jenë të matshme dhe të vlerësuara në mënyrë të vazhdueshme. Bazuar në tabelat përmbledhëse dhe syllabuset e lëndëve, elementët e vlerësimit të vazhduar përfshijnë një gamë të gjerë metodash, duke përfshirë testime të ndërmjetme, vlerësime me shkrim dhe me gojë, ese, detyra dhe projekte kursi. Këto komponentë synojnë të sigurojnë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm të progresit akademik të studentëve. Gjithashtu, studentët gjatë takimit, konfirmuan se marrin udhëzime të qarta mbi strategjitë efektive të përgatitjes për provimin përfundimtar, duke i orientuar ata drejt një qasjeje të strukturuar dhe të thelluar për vlerësimin përmbyllës. <u>Referenca:</u> <i>Tabelat përmbledhëse MTAE</i>

	<i>Shtojca 1.32 Programet lendore</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ bazuar në RVB, dokumentacionin shoqërues, si dhe vizitën në institucion konstaton se ngarkesa mësimore në auditor sipas lëndëve (pjesa teorike), si dhe rezultatet e pritshme për studentin (referuar syllabuseve) u jep mundësi studentëve që të zhvillojnë njohuritë praktike të tyre gjatë zhvillimit të lëndës. Studentët inkurajohen për të punuar në grup edhe në zgjidhjen e detyrave dhe gjatë procesit mësimor, duke konsideruar shembuj praktik nga tregu vendas dhe tregjet ndërkombëtare. Programi i studimit bazohet në një qasje të orientuar drejt kompetencave, duke i ofruar studentëve mundësi të zhvillojnë dhe zbatojnë njohuritë e marra përmes praktikave profesionale, kjo edhe falë marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.41 Marreveshje institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marreveshje bashkëpunimi të FE dhe DMT</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se personeli akademik, si ai efektiv ashtu edhe me kontratë, angazhohet në zhvillimin e orëve të hapura dhe seminareve, duke trajtuar zhvillimet më të fundit në fushën e programit të studimit. Këto aktivitete organizohen si brenda strukturës së programit të studimit, ashtu edhe në formate të hapura për studentët dhe publikun akademik, duke krijuar një mjedis të favorshëm për shkëmbimin e njohurive dhe debatit shkencor. Përmes këtyre seminareve, studentët kanë mundësi të njihen me tendencat më të reja në fushën e tyre të studimit, të zhvillojnë aftësitë e tyre analitike dhe të angazhohen në diskutime mbi problematika dhe sfida aktuale. Këto aktivitete ofrojnë mundësi për studentët dhe stafin akademik që të diskutojnë për zhvillimet më të fundit në përdorimin e sistemeve të rezervimit online, aplikacionet dhe platformat digjitale si: Google Travel, Online Travel Agencies (OTA), Airbnb dhe Experiences; TripAdvisor dhe Viator, etj

	Institucioni gjithashtu mbështet dhe promovon aktivisht pjesëmarrjen e stafit akademik në aktivitete kërkimore dhe seminare ndërkombëtare, duke garantuar një qasje bashkëkohore dhe të përditësuar në procesin mësimor. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.43 Aktivitete e DMT</i> <i>Shtojca 3.8 Mobiliteti i stafit te DMT</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se institucioni demonstroi një angazhim të qartë në nxitjen e ideve inovative dhe zhvillimin e studimeve të përparuara kërkimore nga studentët. Institucioni ofron mbështetje akademike dhe logjistike për studentët e angazhuar në projekte kërkimore dhe iniciativa inovative, duke krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillimin e tyre shkencor dhe profesional. Përmes strukturave të posaçme dhe qasjes së hapur ndaj kërkimit, studentët inkurajohen të eksplorojnë ide të reja dhe të kontribuojnë në avancimin e njohurive në fushën e tyre të studimit. Gjithashtu, institucioni siguron mbështetje financiare për projektet kërkimore të studentëve, duke lehtësuar aksesin në burime dhe infrastrukturë të nevojshme për realizimin e tyre. Kjo mbështetje përfshin financimin e pjesëmarrjes në konferenca shkencore, projekte të aplikueshme në treg dhe bashkëpunime me institucione akademike dhe industri. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.43 Aktivitete e DMT</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se, Personeli akademik ka zhvilluar seminare dhe leksione të hapura me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime. Ky program është i strukturuar në mënyrë që të ofrojë një bazë të fortë teorike, ndërkohë që integron praktika të avancuara që zhvillojnë aftësi specifike dhe kritike për fushën e studimit. Studentët inkurajohen të eksplorojnë ide të reja dhe të kontribuojnë në avancimin e njohurive në fushën e tyre të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se institucioni ka hartuar dhe zbatuar një procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse të studentëve, duke siguruar transparencë dhe qartësi në procesin e realizimit të tyre. Udhëzuesi i vihet në dispozicion studentëve në përfundim të semestrit të parë. Kjo procedurë përcakton në mënyrë të detajuar kriteret, hapat dhe afatet që studentët duhet të ndjekin për përmbushjen e detyrimeve përfundimtare. Përmes kësaj qasjeje, institucioni siguron që të gjithë studentët të kenë informacion të qartë dhe të plotë mbi kërkesat akademike, duke rritur transparencën dhe efektivitetin e procesit të diplomimit. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO</i> <i>Shtojca 2.3 Udhëzues për punimin e diplomë</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik luajnë një rol aktiv në asistimin e studentëve gjatë përmbushjes së detyrimeve përmbyllëse. Institucioni siguron që studentët të kenë akses në informacionet dhe udhëzimet e nevojshme për përgatitjen dhe realizimin e detyrimeve të tyre akademike. Personeli akademik ofron mbështetje të vazhdueshme përmes konsultimeve, mentorimeve dhe ofrimit të materialeve ndihmëse, duke ndihmuar studentët në përgatitjen e punimit të diplomës. Gjithashtu, informacionet e nevojshme afishohen në stendat informuese në mjediset e FE. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO</i> <i>Shtojca 2.3 Udhëzues për punimin e diplomë</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna	Në Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë Master Profesional në Menaxhimi i Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, studentët diplomohen me punim diplome.

gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.33 Kurrikula e programit të studimit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se personeli akademik dhe udhëheqësi i diplomës luajnë një rol kyç në orientimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë procesit të hartimit të punimit përmbyllës. Nga takimi me studentët, u konfirmua që Udhëheqësi i diplomës asiston studentët në përzgjedhjen e temës së punimit, duke siguruar që ajo të jetë e përshtatshme me objektivat akademike dhe kërkimore të programit të studimit. Gjithashtu, ai ofron mbështetje në procesin e kërkimit, analizës dhe përpunimit të rezultateve, duke udhëzuar studentin në hartimin e një pune shkencore të strukturuar sipas udhëzuesve të miratuar nga institucioni. Për të garantuar cilësinë akademike të punimit, udhëheqësi vlerëson përmbytjen dhe rezultatet e arritura, duke vendosur nëse punimi është i plotë dhe i gatshëm për t'u paraqitur para komisionit të vlerësimit. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 2.3 Udhëzues për punimin e diplomë</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se institucioni ofron mbështetje të konsiderueshme për studentët në realizimin e matjeve, analizave dhe testeve të nevojshme për projektet e tyre kërkimore, si brenda ashtu edhe jashtë mjediseve të tij. <i>Por, GVJ rekomandohet pasurimin e Bibliotekës me botime të 5 viteve të fundit.</i> Përmes infrastrukturës akademike dhe laboratorike të disponueshme, si dhe bashkëpunimeve me institucione të tjera, studenti mund të kryejë hulumtime të avancuara që lidhen drejtpërdrejt me temat dhe fushat e studimit të tij. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 3.4 Te dhena infrastruktura</i> <i>Shtojca 3.5 Biblioteka</i>

	<i>Shtojca 3.6 Formati dhe kriteret e vlerësimit të temës së diplomës</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB, konkludon se në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. Vlerësimi bëhet në sistemin shqiptar duke filluar nga 4 (katër) deri në 10 (dhjetë). Vlerësimi i studentit bazohet në një shumëllojshmëri faktorësh, duke përfshirë: • Vlerësimi i udhëheqësit të temës së diplomës • Vlerësimi i oponentit • Vlerësimi i komisionit • Përgjigjet e studentit ndaj pyetjeve • Arritjet akademike të studentit gjatë ciklit të studimit <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 3.6 Formati dhe kriteret e vlerësimit të temës së diplomës</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës, të cilat janë të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kjo procedurë siguron që diplomimi i studentëve është në përputhje me standardet dhe kërkesat kombëtare të arsimit të lartë. Përveç diplomës, studenti pajiset edhe me suplementin e diplomës. Sekretaria mësimore e FE dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student, që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike. <u>Referenca</u> <i>Shtojca 2.6 Modeli i diplomës dhe suplementit të diplomës</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se institucioni siguron ruajtjen e dokumentacionit të studentëve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet e studentëve ruhen në mënyrë të sigurt dhe të organizuar, duke garantuar mbrojtjen e privatësisë dhe të drejtave të studentëve në përputhje me rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale. Përveç kësaj, institucioni është i gatshëm të paraqesë informacione për studentët, rast pas rasti, nëse kërkohen nga

	autoritetet përkatëse ose nga vetë studentët, duke siguruar transparencë dhe akses në informacionin e nevojshëm për të mbështetur proceset akademike dhe profesionale të studentëve. <u>Referenca</u> <i>Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Shtojca 1.10 Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se, Departamenti, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, si dhe sekretaria mësimore asistojnë studentët duke u vënë atyre në dispozicion, informacione, udhëzime dhe materiale të ndryshme të nevojshme në varësi të hapave që duhet të ndiqen për realizimin me sukses të tezës së diplomës.</i> <i>Udhëheqësit e diplomës, mbështesin studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në përfundimin e punimit të diplomës, për të garantuar cilësinë e punimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike dhe profesionale. Institucioni ofron mjedise moderne dhe të pajisura me teknologji të avancuar brenda strukturave të tij, si dhe mundëson mundësi praktike jashtë tij, në bashkëpunim me institucione dhe biznese të fushës, për t'u siguruar që studentët të zhvillojnë aftësi praktike dhe të zbatueshme në fushën përkatëse të studimit. Njësia përgjegjëse për Programin e Studimit siguron që studentët të kenë qasje në laboratorë të teknologjisë digjitale, ku ata mund të përvetësojnë aftësi praktike në përdorimin e sistemeve të rezervimit online; platformat digjitale si Google Travel për

	promovimin e destinacioneve dhe bizneseve turistike; Online Travel Agencies (OTA) për menaxhimin dhe promovimin e hoteleve; Airbnb dhe Experiences për të tërhequr më sa shumë turistë; TripAdvisor dhe Viator për vlerësimin dhe rekomandimet e turistëve dhe organizimin dhe shitjen e paketave për turet turistike. Këto mjedise ofrojnë mundësi për studentët të aplikojnë njohuritë e marra dhe të përgatiten për kërkesat e tregut të punës. <u>Referenca</u> Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale Shtojca 1.45 Udhëzuesi i praktikës Shtojca 3.4 Të dhëna infrastrukturore
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet me organizata dhe institucione të tjera, garanton realizimin e praktikave të studentëve duke ju dhënë mundësinë të njihen direkt me tregun e punës. Ky angazhim siguron që studentët të kenë mundësi të përfitojnë njohuri dhe kompetenca profesionale përmes eksperiencave praktike, duke aplikuar teorinë në kushte reale dhe duke përdorur mjetet dhe teknologjitë më të avancuara. <u>Referenca</u> Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale Shtojca 1.45 Udhëzuesi i praktikës Shtojca 3.4 Të dhëna infrastrukturore
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se praktikrat profesionale, të zhvilluara gjatë studimeve ekuivalentohen në kredite. Praktika është shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe një vlerësim të detajuar, që vlerëson përmbushjen e objektivave të caktuara dhe performancën e studentëve si dhe nga udhëheqësi i praktikës. <u>Referenca</u> Shtojca 1.41 Marrëveshje institucionale Shtojca 1.45 Udhëzuesi i praktikës
Konkluzione	GVJ shprehet se, institucioni ka implementuar një sistem të strukturuar dhe të integruar për realizimin e praktikave profesionale. Praktika ekuivalentohet në kredite, duke siguruar një vlerësim të qartë dhe të drejtpërdrejtë për performancën e studentëve. Ky proces kontribuon në përgatitjen e studentëve për

	<i>kërkesat e tregut të punës dhe avancimin e aftësive të tyre profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1																		
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.																		
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																	
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Referuar dokumentacionit shoqërues të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve (MP_MTAE) ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në Departamentin e për periudhën 2023-2025 është si më poshtë: 1. Për vitin akademik 2023- 2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 10 pedagogë nga të cilët të gjithë PAE; 2. Për vitin akademik 2024- 2025 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë nga të cilët të gjithë PAE;																	
	<table border="1"> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th><th colspan="2">2023 - 2024</th><th colspan="2">2024 - 2025</th></tr> <tr> <th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE:</th><th>PAK:</th></tr> <tr> <td>Prof.Dr</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr> </table>				Tituj/grada	2023 - 2024		2024 - 2025		PAE	PAK	PAE:	PAK:	Prof.Dr	1	-	1	-
Tituj/grada	2023 - 2024		2024 - 2025															
	PAE	PAK	PAE:	PAK:														
Prof.Dr	1	-	1	-														

	Prof.As.Dr	6	-	5	-
	Dr/PhD	3	-	3	-
	Msc	-	-	-	-
	Në total	10	-	9	-
	Gjithashtu, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij. <u>Referenca:</u> RVB Tabelat përmbledhëse MTAE.pdf Shtojca 4.8 Kualifikimet e stafit akademik të FE Shtojca 1.25 Ligji i Arsimit të Lartë, Neni 59, pika 8; Udhëzimi Nr. 29 datë 10.09.2018 Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO Shtojca 4.4 Modeli i kontratës individuale të punës Vizita në Institucion				
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik pranë programit të studimit MP_MTAE është realizuar në përputhje me kërkesat dhe kuadrit rregullator në fuqi sa i takon raportit të PAE dhe PAK. Aktualisht, personeli akademik efektiv mbulon 100% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi, kjo për faktin se niveli i orëve që mbulohet nga pedagogët efektivë të departamentit të MT është i lartë. Nga ana tjetër u konstatua se pedagogë PAE realizojnë deri në 8 lëndë të cilat në disa raste ku respektivisht Prof. Qirici, ka realizuar 485 orë fizike në auditor të realizuara. Të tjerë kanë realizuar gjithashtu mbi 400 orë fizike në auditor të realizuara gjithashtu me nga shumë lëndë. Gjithashtu edhe disa raste të tjera të cilët rezultojnë të kenë realizuar nga 7 dhe 8 lëndë me mbi 400 orë fizike në auditor. Kjo situatë sidomos e shpërndarjes së lëndëve bie ndesh me Udhëzimin Nr. 29, Datë 10. 09. 2018. Nr. 9268 Prot. Pjesa II pika. 6 dhe pika 7.				
	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
	2023-2024	620	620	0	100% / 0 %

	2024-2025	600	600	0	100% / 0 %
	Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. II Ngarkesën Mësimore Vjetore për Personelin Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. Pika 6. Ku thotë: Ngarkesa e plotë mesimore vjetore e personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të përmbaje në një vit akademik më shumë se 3 lëndë semestrale në bazë të programeve të përcaktuara nga njësia bazë, të shpërndarë në dy semestre, ose 2 lëndë vjetore dhe 1 semestrale, ose 3 lëndë vjetore. <i>Ndërkohë që kjo shpërndarje dhe ky përqëndrim i lartë i lëndëve në një pedagog në disa raste nuk është as në përputhje me objektivat dhe mundësitë e stafit PAE për të ruajtur cilësinë por edhe për t'u angazhuar me punë kërkimore në ndihmë edhe të rritjes së kualifikimit personal.</i> <i>GVJ rekomandon nga sa më lartë, një përmirësim në reduktim të kësaj ngarkese mësimore në auditor. Gjithashtu edhe reduktim të lëndëve që është titullar apo jep mësim një pedagog i departamentit të Marketing Turizmi. Kjo jo vetëm në ndihmë të ruajtjes së cilësisë dhe angazhimit me punë kërkimore në ndihmë edhe të rritjes së kualifikimit personal, por sidomos edhe të respektimit të kuadrit ligjor për numrin e lëndëve që një personel akademik duhet të japë në një semestër apo vit akademik.</i> <u>Referenca:</u> RVB Tabelat përmbledhëse MTAE.pdf Shtojca 4.8 Kualifikimet e stafit akademik të FE Shtojca 1.25 Ligji I Arsimit të Lartë, Neni 59, pika 8; Udhëzimi Nr. 29 datë 10.09.2018 Vizita në Institucion				
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit	Bazuar dokumentacionit por edhe gjithashtu vizitës në institucion UNIKO. GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin Master Profesional në				

akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve. Punësimi i stafit PAE është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. <u>Referenca:</u> RVB Tabelat përmbledhëse MTAE.pdf Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO Shtojca 4.4 Modeli i kontratës individuale të punës Vizita në Institucion
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në RVB por edhe në dokumentacionin bashkangjitur paraqiten qartë procedurën e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë bazohet në rregulloren për punësim në UNIKO, e cila paraqet qartë kriteret. Rregullorja përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e kandidatëve në konkurrim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO Shtojca 4.3 Format vendimi komisioni për vlerësimin e kandidatëve Shtojca 4.5 Format urdhër emërimi Shtojca 4.6 Kriteret e rekrutimit Vizita në Institucion
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstatoi që Fakultet i Ekonomisë respektivisht Departamenti i Marketing Turizmit siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e laboratorëve mbështetur tek rregullorja UNIKO. Burimeve Njerëzore, si pjesë e strukturës organizative të UNIKO, arkivon të dhëna të përgjithshme të dokumentuara në dosjet e personelit. Përditësimi i dokumentacionit bëhet nga specialisti i sektorit të burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivit. <u>Referenca:</u> RVB

	<i>Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion që UNIKO, me përgjegjës Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e stafit të angazhuar në programin MP_MTAE. Pas verifikimit në mënyrë rastësore të personelit, GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar. Përgjegjësi i Departamentit, mbledh, përditëson dhe arkivon çdo vit CV-të e anëtarëve të personelit akademik dhe administrativ të përfshirë në programin e studimit. <u>Referenca:</u> RVB <i>Shtojca 1.4 Rregullore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Neni 4, pika c, Neni 5, pika 3</i> <i>Shtojca 4.7 Aktiviteti kërkimor shkencor i DMT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ konstatoi që UNIKO në nivel institucioni por edhe FE dhe DMT kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, institucione dhe organizata biznesi të cilat ndihmojnë dhe ofrojnë studentëve të programit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, praktika profesionale. Praktika profesionale realizohet mbështetur në marrëveshjet e nënshkruara nga UNIKO me institucione dhe biznese të Korçës dhe rajonit. GVJ konfirmoi këtë proces dhe nga takimi me studentët e programit gjithashtu edhe me stafin. Drejtuesi i njësisë kryesore ka transformuar në praktikë lidhen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë pritëse deri një muaj para fillimit të praktikës. Praktikë profesionale zhvillohen në institucione/kompani sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. <u>Referenca:</u> RVB <i>Shtojca 1.41 Marrveshje Institucionale</i> <i>Shtojca 1.42 Marrveshje bashkëpunimi të FE dhe DMT</i>

	<i>Vizita në Institucion</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Bazuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se personeli akademik i departamentit angazhohet në mbikqyrjen në ambientin pritës si edhe në realizimin e praktikave profesionale të studentëve sipas marrëveshjeve të bëra me UNIKO apo FE që të përmbushin detyrimin e kryerjes së praktikës profesionale. Në përfundim të praktikës profesionale, personeli mbikqyrës në ambientin ku realizohet praktika profesionale, përpilon një relacion përfundimtar vlerësimi mbi ecurinë dhe arritjet e studentit për kryerjen e praktikës profesionale. E tërë procedure rregullohet nga Rregullorja e Njesisë Bazë së Departamentit të Marketing Turizëm. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.45 Udhëzues i Praktikës <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet në përmbushje kryesisht të këtij standardi bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në RVB. FE dhe Departamenti i Marketing Turizëm ka të angazhuar personel akademik të duhur për realizimin e programit. GVJ rekomandon që Institucioni të marrë masa për shpërndarjen e lëndëve nga PAE dhe ngarkesën e tyre. Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e stafit të angazhuar në programin MP_MTAE dhe gvj verifikoi dosjet në mënyrë rastësore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në	Departamenti i Marketing Turizëm zhvillon procesin mësimorë në godinën e Fakultetit të Ekonomisë të UNIKO. Bazuar në dokumentacionin e ofruar, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi që mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimorë për programin Master Profesional në Menaxhimin e

përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Përkatësisht, në dispozicion janë: <table border="1" data-bbox="598 241 1425 636"> <thead> <tr> <th>Mjedisi - FB</th><th>Nr. Sallash</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Salla leksioni + seminari</td><td>15</td></tr> <tr> <td>Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj</td><td>4</td></tr> <tr> <td>Zyra për stafin</td><td>13</td></tr> <tr> <td>Bibliotekë</td><td>1</td></tr> <tr> <td>Zyra Informacioni per Studentë</td><td>1</td></tr> </tbody> </table> <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.4 Të dhëna infrastrukturore Shtojca 1.15 Raport i kontrollit të MAS për kapacitetet pritëse të UNIKO 2023-2024 Vizita në Institucion	Mjedisi - FB	Nr. Sallash	Salla leksioni + seminari	15	Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	4	Zyra për stafin	13	Bibliotekë	1	Zyra Informacioni per Studentë	1
Mjedisi - FB	Nr. Sallash												
Salla leksioni + seminari	15												
Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	4												
Zyra për stafin	13												
Bibliotekë	1												
Zyra Informacioni per Studentë	1												
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konstatoi gjatë vizitës që sallat që përdorën gjatë procesit mësimorë janë të pajisura dhe të përshtatshme për përdorim të projektorëve të cilët janë të lëvizshëm dhe thjeshtë të montueshëm nga stafi akademik. Sallat e leksionit dhe laboratorit janë të pajisura me video projektorë disa prej tyre dhe me pc-kompjuter, tabela bashkëkohore, kompjuterë dhe vende pune me internet. Godina e DMT është e pajisur me linjë interneti dhe intraneti (kabëll interneti optik) në të gjitha zyrat e personelit, klasat, laboratorët dhe auditorët, krahas rrjetit të internetit (kabllor/lan) funksionon edhe sistemi wireless i internetit, duke iu mundësuar studentëve akses interneti edhe në ambjentet e jashtme. Sallat e konferencave ku zhvillohen aktivitete ndërinstytucionale dhe ndërkombëtare, të cilat janë të pajisura me pajisje kompjuterike, monitorë, videoprojektorë, smartborde, whiteboards. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.4 Të dhëna infrastrukturore Vizita në Institucion												
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e	Bazuar në vizitën në institucion, por edhe në dokumentacionin e vetëvlerësimit. GVJ konstatoi që Fakulteti Ekonomisë, i cili ofron												

tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	programin Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, ofron për studentët laboratorë dhe gjithashtu salla dhe mjedise të tjera të pajisura me mjete brënda standarteve për të përmbushur kërkesat e programit dhe për të arritur objektivat e tij. Laboratori i turizmit në bashkëpunim me FH është i pajisur me gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e mësimit në mënyrë optimale. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.9 Relacion për bashkëpunim me FH Vizita në Institucion
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Fakulteti Ekonomisë, i cili ofron programin e studimit, ka vendosur ne dispozicion për studentët laboratorin e turizmit në bashkëpunim me FH i cili është i pajisur me gjithë infrastrukturën e nevojshme laboratorin të transferimit të teknologjive, laboratorin e informatikës, laboratorin fushor (EDE), laboratorin (klasa) hibride etj, ku studentët kryesisht realizojnë orët e seminareve për këtë program studimi. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.9 Relacion për bashkëpunim me FH Vizita në Institucion
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe	Bazuar në DVV, RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që Fakulteti Ekonomisë, dhe departamenti i Marketing Turizmit i cili ofron programin Master Profesional në “Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve” ka siguruar marrveshje për bashkëpunim institucional të posaçma vetëm për këtë program studimi, ndër marrveshje që ka realizuar theksohet ai në bashkëpunim me Fondacionin FH për ngritjen e laboratorit të turizmit dhe mikpritjes i cili do të funksionojë si një njësi e cpecializuar për ofrimin e shërbimeve trajnuese në fushën e turizmit. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.9 Relacion për bashkëpunim me FH Vizita në Institucion

ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur plotësisht pasi bazuar në tërë dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion është konstatuar që UNIKO ka në dispozicion të Fakultetit Ekonomisë godinën e cila ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi që pedagogët e lëndëve paraqesin çdo fillim semestri të studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundësohet nga vetë ato dhe biblioteka. Gjithashtu UNIKO vë në dispozicion të studentëve informacione on-line nga burime të ndryshme elektronike si ajo (U Library). Megjithatë në një numër të konsiderueshëm lëndësh, në programet respektive vihet re një mungesë e specifikimit të viteve të botimit të literaturës baze, asaj të detyrueshme. Në disa raste të tjera lëndësh kjo literaturë bazë rezulton të jetë e pa përditësuar. <i>GVJ rekomandon një përditësim më dinamik të literaturës pasi për shumë lëndë raportohet një literature e pa përditësuar ose e përditësuar në gjuhën angleze sidomos ajo e literaturës së rekomanduar.</i> <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.32 Programet Lëndore</i> <i>Shtojca 3.5 Biblioteka</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime	GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi se në të dyja bibliotekat. Si në atë shkencore

të literaturës me botime të viteve të fundit.	të UNIKO_s por edhe në atë të Fakultetit të Ekonomisë raportojnë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit për të informuar stafin akademik, ndihmës-akademik dhe studentët, mbi botimet e fundit. Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj të cilat shpërndahen si materiale shtesë me iniciativë të pedagogëve. <i>Megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkangjitur RVB_së, kryesisht nga (Programet Lëndore të Lëndëve të Programit MTAE), konstatohet në një pjesë dërrmuese të lëndëve e cila vijon të përdorë një literaturë bazë të pa përditësuar me botime të viteve të fundit ose të paspecifikuar viti i botimit.</i> <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.32 Programet Lëndore</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që UNIKO dhe FE vë në dispozicion të studentëve dhe stafit një fond të përgjithshëm i cili arrin 5316 libra dhe 3610 tituj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Biblioteka ofron një hapësirë studimi prej 6 kompjuterash dhe 80 vende studimi. <i>GVJ rekomandon rritjen e aksesueshmërisë me kompjutera në mjediset e bibliotekës. Kjo duke u nisur nga fakti se në programin e studimit MTAE, në një pjesë të mirë të programeve të lëndëve rekomandohet literaturë shtesë e viteve të fundit. Nevojë kjo e cila nxit frekuentim e bibliotekës elektronike më shumë.</i> <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.32 Programet Lëndore</i> <i>Shtojca 3.5 Biblioteka</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e	GVJ konstatoi nga dokumentacioni por edhe vizita në institucion sikurse e theksoj edhe në kriterin 3, se biblioteka disponon dhe një fond fond të përgjithshëm i cili arrin 5316 libra dhe 3610 tituj në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht dhe

mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	frëngjisht. Biblioteka ofron një hapësirë studimi prej 6 kompjuterash dhe 80 vende studimi. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 3.5 Biblioteka</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programin Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, MP_MTAE, që UNIKO ofron për të gjithë dhe pa pagesë bibliotekën online. Biblioteka ofron informacione online nga burime të ndryshme elektronike. Biblioteka Shkencore e UNIKO, duke qënë anëtare e Konsorciumit të Bibliotekave Shqiptare, ka siguruar akses në burime të ndryshme elektronike, informacione të cilat mund të shfrytëzohen nga çdo student dhe pa pagesë. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 3.5 Biblioteka</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, MP_MTAE, se Bibliotekat e Fakultetit ofron informacione online nga burime ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë për stafin e pedagogëve, studentëve dhe përdoruesve të tjerë. Biblioteka shkencore e UNIKO dhe biblioteka e FE funksionojnë me salla studimi dhe të pajisura me 8 kompjutera (internet) dhe video-projektorë duke iu dhënë mundësi studentëve për të punuar në mënyrë individuale dhe në grup duke bërë të mundur që numri i konsiderueshëm i posteve të punës në ambjentet e bibliotekave, dhe përdorimi i pajisjeve kompjuterike, të mundësojë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Aktualisht biblioteka digjitale “U Library” shërbim ky i ofruar nga MAS ofron një numër të madh burimesh elektronike mbi 170.000 libra mbi 70 milionë artikuj akademik. Gjithashtu biblioteka J-Store siguron qasje në më shumë se 12 milion artikuj akademik, libra dhe burime parësore në 75 disiplina.

	<u>GVJ rekomandon nga sa më lartë rritjen e aksesueshmërisë me më shumë vende me kompjutera në mjediset e bibliotekës. Kjo duke u nisur jo vetëm nga fakti se në programin e studimit MTAE, në një pjesë të mirë të programeve të lëndëve rekomandohet literaturë shtesë e viteve të fundit. Nevojë kjo e cila nxit frekuentim e bibliotekës elektronike më shumë. Por sidomos edhe nga kjo disponueshmëri e madhe e bibliotekave online që UNIKO ofron.</u> <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 3.5 Biblioteka Vizita në Institucion
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi se Biblioteka e Fakultetit operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve në orarin e vënë në dispozicion. Orari i shërbimit të bibliotekave, i shpallur gjatë ditëve të javës është: 8:00- 16:00. Për një kapacitet përdoruesish prej: 80 vende studimi. Me një hapësirë studimi prej 163 m² si dhe pajisje kompjuterike në dispozicion të studentëve prej 8 vendesh. <u>Referenca:</u> RVB Vizita në Institucion
Kriteri 8.Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin	Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se stafi i punonjësve të bibliotekës është përgjegjës për raportimin e informacionit që ka të bëjë me përditësimin e fondit fizik dhe fondit on-line të bibliotekës përkatëse. <u>Referenca:</u> RVB Vizita në Institucion

fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur kryesisht, kjo e konstatuar nga dokumentacioni në dispozicion, vizita me stafin dhe studentët e programit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, MP_MTAE. Literatura bazë dhe ndihmëse e programit u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program. Por GVJ rekomandon një përditësim të literaturës bazë, të detyrueshme me dinamike e të viteve të fundit në shumë programe të lëndëve në programin e studimit MTAE. Gjithashtu lipset rritje e aksesueshmërisë me më shumë vende me kompjutera në mjediset e bibliotekës. Kjo duke u nisur jo vetëm nga fakti se në programin e studimit MTAE, në një pjesë të mirë të programeve të lëndëve rekomandohet literaturë shtesë e viteve të fundit. Nevojë kjo e cila nxit frekuentim e bibliotekës elektronike më shumë. Por sidomos edhe nga kjo disponueshmëri e madhe e bibliotekave online që UNIKO ofron për studentët dhe stafin akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion se sekretaria e UNIKO_së është përgjegjëse si edhe realizon sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët nga regjistrimi deri në diplomim. Gjatë takimit në sekretarinë e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe 1 dosje e zgjedhur studenti në programin MP_MTAE, të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi që përdoret mbi bazën e marrveshjes që UNIKO ka bërë me RASH, është platforma PITAGORA si një sistem i

	informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre duke zëvendësuar një sistem elektronik ESSE3 që UNIKO ka përdorur më parë. Sistemi mundëson efikasitet në administrimin e bazës së të dhënave nga ana e stafit akademik, marrje e informacionit në kohë reale nga ana e studentit, shërbime më të mira sekretarie që lehtëson proceset e hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.6 Marrëveshje me RASH për sistemin elektronik Pitagora Vizita në Institucion
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik i angazhuar në programin MP_MTAE menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Drejtorisë Juridike dhe e Burimeve Njerëzore. Ndërsa, Drejtoria e Financës posedon dhe përditëson informacionin në lidhje me stafin akademik dhe administrativ, në funksion të përcaktimit të kategorisë së punonjësve, raportit për ngarkesën mësimore dhe gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me pagat. <u>Referenca:</u> RVB Vizita në Institucion
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma apo sistemi PITAGORA mundëson efikasitet në administrimin e të dhënave nga ana e stafit akademik, marrje të informacionit në kohë reale nga ana e studentëve, shërbime më të mira sekretarie që lehtësoi proceset e hedhjes dhe ruajtjes së të dhënave, paraqitjen në rrjet të grafikut të provimeve, të rezultateve, krediteve, kurrikulës dhe programet lëndore. Rregullorja e këtij programi përcaktoi funksionet e sistemit, si dhe detyrat e përgjegjësitë e personave të përfshirë. Ndërsa hyrja në sistem u mundësua edhe nëpërmjet faqes zyrtare të internetit. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 4.13 Manuali për përdorimin e sistemit elektronik Pitagora

	<i>Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma PITAGORA është sistemi që mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për stafin dhe studentët e UNIKO, por GVJ konstatori si nga RVB dhe nga vizita në institucion ky sistem elektronik konsiderohet si metodë interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët. UNIKO gjithashtu publikon informacione në faqen e vet zyrtare, www.unkorce.edu.al, e cila përditësohet vazhdimisht. Programi i Transparencës, i instaluar në këtë faqe, pasqyron një gamë të gjerë informacioni dhe kornizën ligjore të veprimtarisë së stafit akademik, administrativ dhe të studentëve, marrëdhëniet me publikun, palët e interesit, personat juridikë, etj. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.3 Plani strategjik I zhvillimit UNIKO 2022-2027</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UNIKO garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të UNIKO publikohet në gjuhën shqipe i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. <i>Gjithsesi, GVJ rekomandon që informacionin në faqen ëeb të ofrohet edhe në gjuhën angleze, element që do ta bënte institucionin më atraktiv edhe për studentët e huaj.</i> Gjithashtu në rrjetet sociale çdo fakultet dhe departament pasqyron informacion të vazhdueshëm për të interesuarit. <u>Referenca:</u>

	RVB Vizita në Institucion https://unkorce.edu.al/			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht, UNIKO përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë Universitetit. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të UNIKO. Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet, UNIKO publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet në gjuhën shqipe. GVJ rekomandon që informacioni të ofrohet edhe në gjuhën angleze.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në informacionin e dhënë në DVV dhe RVB, gjithashtu në vizitën pranë institucionit GVJ konstaton se Departamenti i Marketing Turizmit funksionon në përbërje të njësisë kryesore (Fakultetit të Ekonomisë), dhe padyshim është pjesë e njësisë së vetme shpenzuese të UNIKO, pa pasuar buxhet të individualizuar në kuptimin e njësisë shpenzuese. Buxheti financiar hartohet çdo vit nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Financës në drejtimin e administratorit të UNIKO. Buxheti ndahet sipas përcaktimeve të rregullores financiare, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Gjithashtu hartimi i buxhetit të UNIKO_s fillon nga njësia bazë, pra që nga departamenti, duke marrë parasysh nevojat e secilit prej tyre duke, u varur edhe nga niveli i të ardhurave që pritet të realizojë çdo department. Ndërsa plani i financimit miratohet në nivel institucional nga Bordi i Administrimit ku përfshihen të gjitha kostot dhe të ardhurat e parashikuara. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 4.10 Kosto për student</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i>

	<i>Shtojca 1.3 Plani Strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027 Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe	GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV se hartimi i planit të financimit të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, MP_MTAE, bazohet në strukturën buxhetore që përdoret për hartimin e buxhetin e shtetit, sipas zërave kryesorë buxhetorë: Shpenzime nga grandit buxhetor, si dhe Shpenzimet nga të ardhurat e veta. Në vijim plani i financimit të DMT detajohet në mënyrë më analitike me gjithë elementët e shpenzimeve që parashikon për mbulimin e shpenzimeve operative, burimeve njerëzore, investimet për logjistikën dhe pajisjet. <i>Referenca:</i> RVB Vizita në Institucion
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UNIKO auditohet në mënyrë periodike nga tre hallka kryesore. Auditimi i brendshëm financiar nga strukturat e kontrollit të brendshëm të institucionit. Auditimi i jashtëm (i kryer në çdo dy vjet) nga Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si edhe nga auditimi i jashtëm, i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Universiteti bën të njohur pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burime të tjera për të pasur transparencë ndaj publikut. <i>Pavarësisht kwsaj, GVJ nuk u njoh me asnjë raport audit.</i> <i>Referenca:</i> RVB Vizita në Institucion
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në informacionin e DVV në fund të çdo viti UNIKO, rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve. <i>Referenca:</i> RVB

	<i>Shtojca 4.11 Fondet dhe të ardhurat e UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	UNIKO është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UNIKO janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Në rastet kur ka kërkesë të njësisë bazë dhe me miratim të organeve drejtuese të UNIKO, në rastet kur nevojitet financim shtesë, apo përmirësim i situatës financiare, ri-planifikohen ndërhyrje të posaçme në zërat e shpenzimeve (apo në regjistrin e prokurimeve) për nevoja të ndryshimeve eventuale të financimit të programeve të studimeve, duke garantuar mbarëvajtje të veprimtarisë akademike dhe kërkimit shkencor apo të programeve të studimit. <u>Referenca:</u> RVB <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht, pasi u konstatua se UNIKO harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti dhe njësie bazë dhe bën analiza financiare në nivel njësie bazë. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe raportet përcillen deri në njësinë bazë. UNIKO si institucion buxhetor, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UNIKO-s, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e UNIKO-s dhe FE specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.3 Plani Strategjik i zhvillimit të UNIKO 2022-2027 Shtojca 1.34 Rregullore FE Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO Vizita në Institucion https://unkorce.edu.al/
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UNIKO-s, GVJ konkludon se barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantojnë edhe nga ky institucion. Barazi kjo si në lidhje me regjistrimin ashtu edhe përgjatë studimeve, në lidhje me procesin e mësimdhënies, vlerësimit dhe me shërbimet mbështetëse që ofrohen në përputhje me statutin e UNIKO. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO Shtojca 1.34 Rregullore FE Vizita në Institucion
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në	GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe RVB, dhe pas vizitës në institucion, konstatoi që UNIKO harton dhe bën publike kritere dhe kuotat e pranimit për çdo cikël studimesh, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Konstatohet se në programet e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në

programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve pranojnë studentët duke u bazuar në udhëzimet dhe kuotat e paracaktuara në aktet nënligjore përkatëse të Këshillit të Ministrave dhe MAS, për vitin akademik përkatës. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.25 Ligji i Arsimit të lartë</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 1.2 Rregullore e UNIKO</i> <i>Shtojca 1.34 Rregullore FE</i> <i>Shtojca 1.46 Rregullore DMT</i> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit</i> <i>Shtojca 1.25 Udhëzim Nr. 15 dt. 20/05/2020; Udhëzim Nr. 17 dt. 30/07/2019; Udhëzim Nr. 10 dt. 15/05/2019;</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO, procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të interesuarit. Këto kriteret dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen zyrtare të universitetit. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>udherefyesi2022.pdf(unkorce.edu.al)</i> <i>https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/udherefyesi2022.pdf</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO përveç komunikimit elektronik, për informimin e publikut shërbejnë dhe takimet me të diplomuarit e ciklit të parë bachelor, si dhe aktivitetet që organizohen nga Fakulteti apo edhe Departamenti i MT. Universiteti menaxhon edhe forma informimi më të gjerë si Guida e Universitetit, broshura promocionale për programet e studimit dhe kriteret e pranimit, lajmërimi në media. Studentët informohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit dhe llogarive zyrtare të UNIKO në rrjete sociale (FB dhe Instagram), mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si

	pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i> <i>Shtojca 1.25 Udhëzim Nr. 12 dt. 30/06/2023</i> https://unkorce.edu.al/ https://unkorce.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/udherefyesi2022.pdf
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ konstatoi se UNIKO ka hartuar kuotat e pranimet për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Programi Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve nuk përjashton mundësinë e integritit të shtresave më vulnerabël të shoqërisë. Ky program studimit, parashikohen kuota të dedikuara për kandidatë me aftësi të veçanta, nga pakica dhe shtresa të marxhinalizuara. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.25 Udhëzim Nr. 12 dt. 30/06/2023</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në kuadrin rregullator të UNIKO parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve shqiptarë etnikë jashtë kufijve shtetrorë, si edhe nga çdo shtetas i huaj, por që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimet në programin e studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 1.34 Rregullore FE</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimet në programe me përparësi për	UNIKO duke ndjekur dhe kuadrin rregullator në fuqi, njofton dhe ofron bursa apo përfitim financiar për studentët e shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar sikurse është konsideruar gjithashtu edhe ky program studimi. <u>Referenca:</u>

institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	RVB <i>Shtojca 1.25 VKM Nr. 903, dt 21.12.2016 me ndryshime Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht, duke konstatuar se në kuadrin rregullator të UNIKO parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet Master Profesional në MTAE, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. UNIKO ka hartuar kuotat e pranimit për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UNIKO, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit Ekonomisë dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin por UNIKO aplikon gjithashtu dhe sistemin e automatizuar të Pitagorës, i cili jep akses studentëve të informohen në kohë reale për vlerësimet e tyre, programet e lëndëve dhe gjithë ciklit të studimeve. Gjithashtu, studentët marrin informacione të hollësishme edhe pranë “Zyrës së informimit të studentëve”, sekretarisë mësimore të departamentit apo sekretarisë së sistemit. <u>Referenca:</u> RVB <i>Shtojca 1.34 Rregullore FE</i> udherefyesi2022.pdf (unkorce.edu.al) https://unkorce.edu.al/

	<i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO përmes sekretarive të programeve të ciklit të dytë dhe bazuar në rregullore të FE informon dhe orienton studentët në lidhje mundësinë për njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, studentët marrin informacione të hollësishme edhe pranë “Zyrës së informimit të studentëve”, sekretarisë mësimore të departamentit, sekretarisë së sistemit. <u>Referenca:</u> RVB <i>Shtojca 1.34 Rregullore FE</i> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit udhërefyesi2022.pdf (unkorce.edu.al)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve. Studentët mund të marrin informacion të hollësishëm edhe pranë “Zyrës së informimit të studentëve”, sekretarisë mësimore të departamentit, sekretarisë së sistemit. <u>Referenca:</u> RVB <i>Shtojca 1.34 Rregullore FE</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita studentët e programit të studimit, rezultoi se ishin të informuar lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi. Diplomimi bëhet me realizimin e një teme diplome ku studentët në bashkëpunim me udhëheqësin e kanë përgatitur atë. Referuar rregullores së njësisë bazë, në dhjetor, departamenti përcakton fushat e studimit, listën e temave të diplomës si dhe pedagogun udhëheqës. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e



	studimit që mbulon departamenti. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës dhe peshën që zë kjo kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit, sipas llojit të programit, përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.34 Rregullore FE</i> <i>Shtojca 2.13 Fushat e studimit dhe temat e diplomës</i> <i>Shtojca 1.32 Programet Lëndore</i> <i>Shtojca 2.3 Udhëzues për punimin e diplomës</i> <i>Shtojca 1.30 Analiza e veprimtarisë QKA</i> <i>udherefyesi2022.pdf (unkorce.edu.al)</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare të UNIKO_s, GVJ konstatoi se Departamenti i Marketing Turizmi, në koordinim me strukturat e FE dhe UNIKO, përfshirë edhe QKA, organizon takime informuese duke synuar dhënien e informacioneve të nevojshme në lidhje me elementët e përmbajtjes së programeve të studimit dhe nevojat e tyre të të nxënit. UNIKO organizimi gjithashtu fushata promovuese me studentë të viteve të fundit bachelor, harton broshurave informative dhe prezantime gjatë vizitave në to përbëjnë një pjesë të veprimtarive të realizuara. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.30 Analiza e veprimtarisë QKA</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ e gjykon këtë kriter të përmbushur plotësisht, duke konstatuar se UNIKO vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre përmes platformës së Pitagorës, si dhe mbi procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Gjithashtu studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procesin e diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	ësVlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, informohen nga pedagogët përkatës, sekretarët dhe faqja zyrtare web e UNIKO për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit të cilat u jepen studentëve në ditët e para në auditor dhe në faqen zyrtare apo rrjetet sociale të institucionit. Përmes platformës në përdorim dhe takimeve të organizuara studentët mund të konsultojnë syllabuset dhe informacione të përditësuara mbi veprimtaritë mësimore. <i>Referenca:</i> <i>Shtojca 1.34 Rregullore FE</i> <i>Shtojca 1.28 Rregullore të programit të studimit</i> <i>https://unkorce.edu.al/archive/programet_studimet/FE/index.php</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO publikon faqen e vet zyrtare, www.unkorce.edu.al, e cila përditësohet vazhdimisht me informacion. GVJ sugjeron që informacioni të ofrohet edhe në gjuhën angleze. Gjithashtu, programi i transparencës, pasqyron një gamë të gjerë informacioni dhe kornizën ligjore të veprimtarisë akademike, administrative dhe të studentëve, marrëdhëniet me publikun, palët e interesit, personat juridikë. GVJ u njoh me disa aktivitete që organizohen në UNIKO në kuadër të orientimit, ku më i rëndësishmit janë Ditët e Promocionit, ku ofrohet informacion mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, si edhe aspekte të tjera të rëndësishme në lidhje me programin Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve.



	<u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.32 Programet Lëndore</i> <i>UNIKO-PROGRAMET E STUDIMIT (unkorce.edu.al)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO ka lidhur 46 marrëveshje në vazhdimësi me institucione dhe biznese për të mbështetur studentet e tyre gjatë praktikave dhe mbi të gjitha për tju ofruar mundësi punësimi. Stafi akademik i FE dhe DMT, në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës, në mënyrë sistematike, angazhohet në përpjekje konkrete që kanë të bëjnë me orientimin e studentëve në tregun e punës, në eksplorimin e mundësive dhe alternativave për administrimin e karrierës së tyre. DA realizon studim tregut të punës i cili ka siguruar një rrjet komunikimi institucional, që përfshin institucionet arsimore në rajon, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, njësitë administrative, bizneset private. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.29 Studime tregu</i> <i>Mundësi Punësimi - Universiteti "Fan S. Noli" Korçë</i> <i>(unkorce.edu.al)</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstatoi se Sekretaritet Mësimor si dhe pedagogët e Departamentit të Marketing Turizmit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi, që në fazën e regjistrimit të studentëve e më pas me fillimin e vitit akademik. Gjithashtu Sektori i Studimeve menaxhon mbledhjen, përpunimin, dhe transmetimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Studentët informohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit dhe llogarive zyrtare të UNIKO në rrjete sociale (FE dhe Instagram) mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillin e studentëve, veprimtari, njoftime etj.

	<u>Referenca:</u> RVB udherefyesi2022.pdf (unkorce.edu.al) https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstatoi se UNIKO dhe FE kanë ngritur një sistem të organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. Sektori i Studimeve menaxhon mbledhjen, përpunimin, dhe transmetimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu ky informacion shpërndahet në rrjete sociale (FE dhe Instagram) shpallet në stenda dhe monitorë të dukshme në fakultet. <u>Referenca:</u> RVB Vizita në Institucion			
Konkluzione	GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht pasi konstatoi se në UNIKO studentët e programit të studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, MP_MTAE, informohen nga pedagogët përkatës, sekretarët dhe faqja zyrtare web e UNIKO si edhe Sektori i Studimeve për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. FE ka dhe rrit numrin e marrëveshjeve, duke ua vënë në dispozicion studentëve me qëllim orientimin e tyre drejt tregut të punës, gjithashtu kujdeset për informimin dhe këshillimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO nëpërmjet Sektorit të Studimeve dhe TIK mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Gjithashtu është përgjegjës për zbatimin dhe mirëmbajtjen e platformës “PITAGORA” së sistemit dixhital të të dhënave të universitetit, si një mënyrë efikase dhe praktike komunikimi. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në USH, GVJ konstatoi se në UNIKO krahas sektorit të Studimeve dhe TIK i cili menaxhon sistemin, mjetet dhe procedurat e informimit të studentëve. Duke menaxhuar mbledhur, përpunuar, transmetuar dhe shfrytëzuar të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu edhe Sekretaria Mësimore mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore për regjistrimet e studentëve sipas programeve, përfshi numrin e studentëve të regjistruar, numrin e të diplomuarve, numrin e studentëve që ndërpresin studimet. Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. Për vitin akademik 2023-2024 rezultojnë të jenë regjistruar 9 studentë, ndersa për këtë vit akademik rezultojnë të jenë regjistruar 5 studentë. Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjen personale dhe të ecurisë akademike të një studenti të programit të studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve konstatoi plotësinë e tyre. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe TIK</i> <i>Shtojca 3.2 Raportet vjetore të DMT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të	Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UNIKO-s dhe Fakultetit të Ekonomisë. Sektori i Studimeve dhe TIK menaxhon sistemin,

jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	mjetet dhe procedurat e informimit të studentëve. Ai menaxhon mbledhjen, përpunimin, transmetimin dhe shfrytëzimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga regjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre. Ai koordinon mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre në bashkëpunim me sektorët e administratës në Rektorat. Sektori përpunon statistikën e të dhënave të ndryshme nga viti në vit dhe ua komunikon ato njësive përkatëse në universitet. Informacioni përcillet edhe në bazën e të dhënave të sistemeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve. Studentëve u jepet mundësia të regjistrohen (krijojnë llogari me user name dhe password unik) në sistemin Pitagora. Në këtë sistem, ka të dhëna për studentët në nivel individual dhe hidhen të dhënat nga pedagogët në lidhje me vlerësimin e studentëve (gjatë vitit dhe në provime) <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe TIK</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mësimor, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO kontrollon në mënyrë periodike në nivel fakulteti dhe universiteti të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe veprimtaritë e tyre përkatëse. Sektori i kurrikulës vlerësimin institucional dhe Alumni, është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës dhe në hartimin e një plani pune për përmirësimet e mundshme. Në Manualin e Cilësisë të UNIKO përshkruhet e tërë veprimtaria e tij dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e NJSBC në fakultete, sekretaritet mësimor dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.10 Rregullore e Sektorit të Studimeve dhe TIK</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike,	Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB por edhe dokumentacionit në DVV, njësia bazë DMT, në mënyrë periodike,

periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	harton dhe analizon raporte analitike mbi ecurinë e veprimtarisë akademike e mësimore, ku ndër të tjera, evidentohen edhe aspekte që kanë të bëjnë me cilësinë, në hyrje dhe dalje të studentëve, dhe në lidhje me sfidat dhe mundësitë e punësimit të tyre. Njësia bazë mbështetet në këtë informacion për të realizuar analizat periodike. <i>Referenca:</i> Shtojca 3.2 Raportet vjetore të DMT Shtojca 2.5 Të dhëna nga sektori i studimeve dhe sektori TIK Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm të FE Vizita në Institucion			
Konkluzione	GVJ konstatoi se UNIKO mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Sistemi i brendshëm i informacionit i UNIKO-s mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UNIKO në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundur ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik të UNIKO, dhe në Bordin e Administrimit. Këshillat studentore në UNIKO kanë organizime të pavarura të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë.

	<u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ konstatoi se jo vetëm në statutin e UNIKO por edhe në rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në një proces transparent. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.1 Statuti i UNIKO</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca 1.18 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese</i> <i>Shtojca 1.17 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ konstatoi se aktualisht UNIKO përdor në fund të çdo semestri pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor dhe stafin akademik. Në pyetësor studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 3.1 Modeli dhe raporti i pyetësorit studentor</i> <i>Shtojca 1.5 Rregullore DKVI</i> <i>Shtojca 2.16 Model pyetësori fundkursi</i> <i>Shtojca 2.17 Relacion i pedagogut</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e USH, GVJ konstatoi se në çdo fund semestri studentët kanë mundësi të reflektojnë dhe paraqesin vlerësimet e tyre mbi procesin mësimorë dhe procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve me anë të pyetësorëve të cilët mund ti plotësojnë për çdo lëndë dhe pedagog. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 4.12 Regjistri i pedagogut</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se UNIKO mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Sistemi i brendshëm</i>

	i informacionit i UNIKO mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. DMT në bashkëpunim me Zyra e Karrierës dhe Alumni analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstatoi se UNIKO është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), duke mundësuar, në këtë mënyrë përdor sistemin “Pitagora” si një sistem dixhital në shërbim të studentëve. UNIKO nëpërmjet kësaj platforme mundëson komunikimin e stafit akademik dhe studentëve duke përfshirë komunikim nëpërmjet adresave elektronike me domain @unkorce.edu.al. Por një tjetër rrugë komunikimi kanë qënë edhe rrjetet sociale të internetit, të gjitha këto forma kanë mundësuar informimin në kohë reale të të gjithë palëve të interesit mbi aktivitetin e UNIKO. <i>Referenca:</i> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi se në UNIKO dhe FE është ngritur një sistem i organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor. I gjithë informacioni i detajuar në lidhje me programet e studimit të ofruara, stafin akademik, kurrikulën, rezultatet e të nxënit, kurset dhe rezultatet e provimeve, paraqitet në llogaritë personale të çdo studenti në platformën dixhitale Pitagora. Sektori i Studimeve dhe TIK si edhe Sekretaritetë garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në

	nivel Universiteti; si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.31 Modulet orientuese për studentët</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	DVV, GVJ konstaton se NJSBC e UNIKO vazhdimisht përdorin mjete për të vlerësuar përparimin e studentëve. UNIKO gjithashtu nëpërmjet Qendrës së Karrierës, ka krijuar profilin e një ure lidhëse mes tregut dhe UNIKO duke synuar përditësimin e vazhdueshëm të njoftimeve për vende të reja pune. Qendra gjithashtu njofton në kohë reale studentët e diplomuar (dhe ata aktualë) për çdo njoftim që vjen nga Zyra e punës. Sa i takon orientimit në praktika profesionale dhe tregut të punës, UNIKO ka ndihmuar në drejtim të marrveshjeve që ka me 46 Institucione dhe Organizata bashkëpunuese. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstatoi se Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional & Alumni dhe Qendra e Karrierës organizojnë trajnime dhe aktivitete të ndryshme me studentët, ku diskutohet dhe orientohen studentët, mbi zhvillimin e karrierës, hartimin e CV-ve dhe përpilimin e dosjes personale, prezantimin gjatë intervistave të punës. Gjithashtu studentët informohen vazhdimisht nëpërmjet faqes së internetit dhe llogarive zyrtare të UNIKO në rrjete sociale (FB dhe Instagram) mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si pranimet, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillin e studentëve, veprimtari, njoftime. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 1.30 Analiza e veprimtarisë QKA</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Konkluzione	<i>Sekretaritet Mësimor dhe e Karrierës dhe ALUMNI të UNIKO janë struktura në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Qendra Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me fakultetet në UNIKO, gjurmon punësimin e studentëve të diplomuar.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e UNIKO, GVJ konstatoi se UNIKO i ka strukturat dhe procedurat të mirëpërcaktuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me strategjinë institucionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. Këto struktura janë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UNIKO. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët UNIKO monitoron në vazhdimësi proceset, veprimtaritë, burimet njerëzore dhe kontekstin në të cilin realizohet misioni i tij si një qendër arsimore dhe kërkimore. Treguesit kryesorë të performancës maten, përmes hartimit të raportit të vetëvlerësimit, monitorimit të vazhdueshëm të dokumentacionit, rritjes së ndërgjegjësimit të rolit të stafit dhe studentëve në sigurimin e cilësisë, përmes anketave dhe pyetësorëve, përcaktimit të rekomandimeve për përmirësim dhe ndjekjes në vijimësi të masave të ndërmarra. Vlerësimi i stafit akademik për cilësinë e mësimdhënies kryhet nëpërmjet pyetësorit të përgjithshëm i cili zhvillohet nga NjSBC në

	bashkëpunim me këshillin studentor. Performanca e stafit akademik vlerësohet në kuadër të arritjeve në fushën e akademike dhe kërkimore të gjithsecilit nëpërmjet analizave në përfundim të një moduli, si dhe gjatë analizave vjetore të departamentit sipas modelit të miratuar në manualin e cilësisë. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Kuadri rregullator i UNIKO u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UNIKO. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 3.1 Modeli dhe raporti i pyetësorit studentor Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ konstatoi se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës, pjesë e së cilit është edhe Qendra e Karrierës dhe Alumni në UNIKO. GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve janë diskutuar në mbledhjet e Dekanateve ose në departamente; synimi është nxitja e diskutimit në lidhje me nevojën për përmirësimin e kurrikulës, metodave të mësimdhënies apo infrastrukturës në të cilën ajo zhvillohet. Në fund të çdo viti, rezultatet e auditimit raportohen në takimet e hapura, të organizuara në formën e analizave vjetore të punës, me pjesëmarrje të gjerë të asamblesë akademike dhe studentëve. <u>Referenca:</u> <i>Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE Vizita në Institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të	Bazuar në informacionin e RVB dhe DVV, gjithashtu dhe nga vizita me stafin dhe përfaqësues së NJSBC, GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve të personelit duke u bërë pjesë e mbledhjeve

marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	në dekanat dhe departament, ka si qëllim dhe diskutimet konstruktive, të cilat promovojnë praktikën e mira dhe nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm. Nga UNIKO stafi akademik mbështetet të kryejë studime brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet vitit sabbatik, si dhe nxitet të marrë pjesë në tryeza të rrumbullakëta diskutimesh dhe në trajnime, që janë pjesë e kornizës zbatuese të projekteve ndërkombëtare ku universiteti është pjesë. UNIKO promovon stafin akademik nëpërmjet organizimit të veprimtarive që prezantojnë për një publik më të gjerë kontributin akademik dhe shoqëror të kërkimit shkencor të stafit të tij. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (unkorce.edu.al)</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se Sekretariteti Mësimor dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit të UNIKO janë struktura në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Zyra e Këshillimit të Karrierës. Zyra e Këshillimit të Karrierës në bashkëpunim me fakultetet në UNIKO, gjurmon punësimin e studentëve të diplomuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, në planin strategjik 2022-2027 të UNIKO, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, dhe planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë. Parimi i cilësisë vlerësohet si udhëheqës i aktivitetit organizativ të Universitetit dhe duke ndjekur kuadrin ligjorë. Në FE siguri i brendshëm i cilësisë

aktet rregullatore institucionale.	realizohet sipas rregullave të përcaktuara të Rregullores së Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore të FE “Vlerësimi i cilësisë “ku specifikohen procedurat dhe strukturat për vlerësimin e cilësisë. Sektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni (SKVIA) është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e një plani pune për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe në Manualin e Cilësisë të UNIKO dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e NJSBC në fakultete dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 6.1 Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë të FE</i> <i>Shtojca 1.3 Planin strategjik I zhvillimit UNIKO 2022-2027</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se UNIKO ka krijuar strukturat e brendshme, proceset dhe udhëzimet e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe ka në përbërje një njësi të posaçme që merret me sigurimin e cilësisë së programeve të studimit dhe me bashkërendimin e procedurave që synojnë përmirësim të vazhdueshëm. Sektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e planeve për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe në Manualin e Cilësisë të UNIKO dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Sektori i Kurrikulës në fakultete, dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve dhe organeve drejtuese të universitetit, për masat që duhet të ndërmerren. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.25 Ligji i Arsimit të lartë</i> <i>Shtojca 1.33 Kurrikula e Programit të Studimit</i> <i>Shtojca Kodi i Cilësisë</i> <i>Vizita në Institucion</i>

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UNIKO realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. UNIKO i është nënshtruar (dy herë) Akreditimit Institucional, ndërsa vetëvlerësimi i programit të ciklit të dytë të studimit Master Profesional në Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve, po kryhet në kuadër të procesit të akreditimit, i cili do të pasohet nga ky vlerësimi i jashtëm, që po realizohet nga ASCAL. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.24 Manuali për vlerësimin e performacës së stafit akademik Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (unkorce.edu.al) Vizita në Institucion https://unkorce.edu.al/
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualet e UNIKO dhe FE paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie (<u>moment ky që kemi dhënë konstatimin tonë për realizimin më të mire të tij</u>). Rezultatet e treguesve të performancës, (pjesë e raporteve vjetore të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore), diskutohen në fund të çdo viti, në takimet e organizuara me anëtarët e stafit akademik të departamentit, me fokus promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 6.4 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, shkencore dhe Financiare e FE Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (unkorce.edu.al) https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion
Konkluzione	GVJ konstatoi se në UNIKO procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet

	<i>ligjore e nënligjore në fuqi. Instrumentat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri si dhe analizat e ecures të realizuara në nivel Departamenti, Marketing Turizmi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konstatoi nga DVV dhe RVB se FE, bazuar në Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore, organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore. duke angazhuar komisionin ad-hoc për rishikimin e programeve të studimit dhe rregulloreve përkatëse. UNIKO përdor mekanizma e procese të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve sipas rregulloreve të studimit. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.24 Manuali për vlerësimin e performacës së stafit akademik</i> <i>Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (unkorce.edu.al)</i> <i>https://unkorce.edu.al/</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe	GVJ konstatoi nga RVB si edhe dokumentat e DVV se raportet e analizës vjetore të mësimit dhe punës kërkimore shkencore që kryhet në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe IAL-je. Të cilat përfshijnë performancën e stafit dhe veprimtarisë në çdo komponent

arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	të saj, qoftë atë mësimor apo kërkimor si dhe formimin profesional të studentëve. Këto raporte përmbledhin evidencat me anë të së cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë e veprimtarive akademike dhe mësimore mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Komisioni i sigurimit të cilësisë, programeve të studimit e kërkimit shkencor - Universiteti "Fan S. Noli", Korçë (unkorce.edu.al)</i> <i>Relacioni përmbledhës-pyetësori-2023-1.pdf(unkorce.edu.al)</i> https://unkorce.edu.al/ <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni i DVV dhe RVB se UNIKO vlerësimi i treguesve të performancës, të realizimit apo mbarëvajtjes së programeve të studimit, bazohet në metodologji e cila synon matjen/vlerësimin e indikatorëve sasiorë dhe cilësorë, lidhur me programet e studimit që ofron njësi bazë mbi procesin mësimor, performancën e stafit akademik, studentët, organizimin dhe menaxhimin e brendshëm, veprimtarinë mbështetëse etj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies bazohet në të dhënat që përfitohen nëpërmjet anketimit të studentëve. Gjithashtu, janë aplikuar edhe orë të hapura leksionesh nga pedagogë me tituj shkencorë (profesorë dhe titullarë lëndësh, me eksperiencë të gjatë në mësimdhënie), me qëllim ofrimin e përvojës së tyre në funksion të përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies nga ana e lektorëve të rinj. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 6.4 Analiza vjetore e veprimtarisë mësimore, shkencore dhe Financiare e FE</i> <i>Shtojca 6.6 Platforma Clean Score</i> <i>Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (unkorce.edu.al)</i> https://unkorce.edu.al/ <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	Bazuar në informacionin e DVV dhe RVB, GVJ konstatoi se programet e studimit në UNIKO i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të cilësisë, nëpërmjet instrumentave të tërthorta të NJBSC_së, organeve vendimmarrëse, stafit akademik dhe

studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	studentëve. Këto instrumenta rezultojnë të jenë kompleks: Sjellja dhe veprimtaria e stafit akademik matet edhe me të dhëna e pyetësorëve të studentëve, intervistat në panairin e karrierës, anketimet e ndryshme me të diplomuarit në FE, për të vlerësuar programet e studimit. GVJ vlerëson këtë iniciativë të pasurimit të metodave të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit MP_MTAE. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.30 Analiza e veprimtarisë QKA Relacioni përmbledhës-pyetësori-2023-1, pdf(unkorce.edu.al) https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion			
Konkluzione	GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitormin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel institucioni Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësore dhe sasore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët, dhe evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës. UNIKO së fundmi ka pasuruar kuadrin rregullator mbi metoda të reja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të	Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit në DVV dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UNIKO, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në Manualin e

jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Cilësisë specifikohen funksionet e të gjitha strukturave që nga Senati Akademik dhe deri tek pedagogët. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca 6.1 NJSBC</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në rregulloren e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Statuti i UNIKO thekson organizimin strukturor të sigurimit të cilësisë, nëpërmjet rrjetit të cilësisë apo DKVIA e ngritur në nivel IAL-je si dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) në çdo njësi kryesore të UNIKO. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.16 Manuali i cilësisë UNIKO</i> <i>Shtojca 6.1 NJSBC</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	GVJ vlerëson se UNIKO garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 3.2 Raportet vjetore të DMT</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo	GVJ vlerëson se UNIKO nëpërmjet DKVIA, në bashkëpunim me njësitë bazë si edhe SKVIA garanton procesin e sigurimit të cilësisë është gjithëpërfshirës, transparent, i diskutuar me stafet dhe i bazuar në formate e procedura të miratuara dhe të bëra publike. Pranë FE është ngritur Njësia e Sigurimi të Cilësisë me anëtarë nga personeli akademik dhe një student është pjesë e Grupit të Vlerësimit të

pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Brendshëm të këtij programi studimi. Kjo njësi funksionon në respektim të plotë të integritetit të aktorëve. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se UNIKO angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe institucioneve të jashtme që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Ky bashkëpunim konsiston në ndihmë të procesit të realizimit të praktikave mësimore-profesionale, FE ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me operatorë të sektorit privat si dhe me institucione të ndryshme rajonale, duke u përpjekur t'i përfshijë ata, në diskutime dhe shkëmbim opinionesh, me synim përmirësimin e procesit të mësimdhënies, kërkimit apo rritjes së cilësisë së programeve të studimit. <u>Referenca:</u> <i>RVB</i> <i>Shtojca 1.42 Marrëveshje bashkëpunimi të FE dhe DMT</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Përmes aktiviteteve si, leksione të hapura me biznese private por edhe personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, UNIKO realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascq.al

E-mail: info@ascq.al

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Bazuar në informacionin e dhënë në RVB, DVV dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UNIKO parashikon publikimin e politikave, strategjive dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë. Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti dhe përfshijnë një sërë dokumantash që janë publike dhe lehtësisht të aksesueshme. <u>Referenca:</u> RVB Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (unkorce.edu.al) https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Publikimet në faqen zyrtare web të UNIKO dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Gjithashtu rezultatet e vlerësimit të programit të studimit, diskutohen në takimet e organizuara në nivel departamenti, në të cilën merren masat për përmirësimin e dobësive. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (unkorce.edu.al) https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstatoi se FE, në bashkëpunim me departamentet (përfshi edhe DMT), në fillim të çdo viti akademik miraton një plan veprimi aktiviteteve, të cilat kanë të adresuara dhe synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara nga proceset e vetëvlerësimit dhe marrjes së rezultatit në vitin paraardhës, me qëllim përmirësimin e ecursisë së programeve të studimit për vitin e ri akademik. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE

	Universiteti "Fan S. Noli" Korçë (unkorce.edu.al) https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UNIKO realizohen periodikisht analiza gjithashtu si edhe në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet e nevojshme dhe përmirësimet e nevojshme. Raportet e veprimtarisë së DMT përmbajnë jo vetëm analizën e ecurisë dhe arritjet por gjithashtu japin dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimet e nevojshme. <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 2.5 Tëdhëna nga sektori i studimeve dhe sektorit TIK https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi se takimet e organizuara në nivel të Njesisë Kryesore (FE) dhe të Njesisë Bazë (DMT) ofrojnë informacione të nevojshme tek stafi akademik mbi arritjet, mangësitë dhe problematikat, lidhur me cilësinë e proceseve të mësimdhënies dhe punës kërkimore, në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme të cilësisë së personelit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm të fushës . <u>Referenca:</u> RVB Shtojca 6.3 Raporti i vlerësimit të brendshëm FE Shtojca 1.43 Aktivitetet e DMT https://unkorce.edu.al/ Vizita në Institucion
Konkluzione	GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi konstatoi se UNIKO publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë palëve të interesuara. Materialet e publikuara dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Në raportet e analizës në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti përfshihen dhe tregues të matshëm për vlerësimin e efektivitetit të aktivitete të ndërmarra për monitorimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë. Institucioni angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Menaxhimin e Turizmit, Atraksioneve dhe Eventeve”, ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Pikat e forta dhe afirmime

1. Institucioni ka angzhuar në programin e studimit personel akademik me eksperiencë të gjerë në fushën përkatëse të studimit dhe me një karrierë akademike të pasur.
2. Institucioni disponon një infrastrukturë të mirë-organizuar dhe ofron mbështetje financiare për mobilitetin e studentëve dhe zhvillimin akademik të pedagogëve.
3. Institucioni ka krijuar bashkëpunime të frytshme me institucione publike dhe jopublike brenda vendit, duke i mundësuar studentëve zhvillim praktike profesionale dhe punësim të menjëhershëm pas përfundimit të studimeve.
4. Numri i mobiliteteve të personelit akademik që ka marrë pjesë në projektet Erasmus+ ka sjellë një ndikim mjaft pozitiv për të përmirësuar më tej kompetencat si në fushën e mësimdhënies ashtu edhe në atë kërkimore.

Pika të dobta:

1. Stafit akademik PAE të angazhuar në kështu program studimi rezultojnë me një sasi lëndësh të realizuara shumë të lartë (deri në 8 lëndë në vit) dhe në disa raste me një sasi orësh fizike në auditor shumë të lartë (deri në 485 dhe 420 orë për një pedagog).
2. Konstatohet në një pjesë dërmuese të lëndëve vijon të përdorë një literaturë e pa përditësuar me botime të viteve të fundit.

Rekomandime:

1. Institucioni duhet të reduktojë sasinë e lëndëve të realizuara nga një pedagog në nivel viti akademik, brenda kornizës ligjore në fuqi si dhe të reduktojë sasinë e orëve fizike në auditor në funksion të cilësisë jo vetëm akademike mësimore por edhe asaj të kërkimit shkencor.
2. Literatura bazë e detyrueshme në programin mësimorë duhet përditësuar mbi bazën e botimeve të 5 viteve të fundit.
3. UNIKO si edhe DMT duhet të ketë në konsideratë rekrutimin e stafit në kategorinë PAK, në këtë program studimi, ose të rekrutimit të stafit PAE me qëllim reduktimin e ngarkesës mësimore në auditor të stafit ekzistues PAK.
4. Të shtohet numri i PC-ve në ambjentet e bibliotekës në dispozicion të studentëve. Në mënyrë që biblioteka on line të mund të aksesohet nga sa më shumë studentë njëkohësisht në funksion të përgatitjes së tyre për detyrimet e lëndëve, por edhe për punët kërkimore.
5. UNIKO sugjerohet të azhurnojë faqen e saj zyrtare me informacion edhe në gjuhën angleze.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in "Tourism Attractions and Events Management", "Fan S. Noli" Korça University

Strengths and affirmations

1. The institution has engaged academic staff with extensive experience in the respective field of study and a rich academic career in the study program.
2. The institution possesses a well-organized infrastructure and provides financial support for student mobility and the academic development of faculty members.
3. The institution has established fruitful collaborations with public and non-public institutions within the country, providing students with opportunities for professional practical development and immediate employment upon completion of their studies.
4. The number of academic staff mobilities that have participated in Erasmus+ projects has had a highly positive impact, further enhancing competencies in both teaching and research.

Weaknesses

1. The PAE academic staff engaged in these study programs result in a very high number of completed courses (up to 8 courses per year) and in some cases with a very high number of physical hours in the auditorium (up to 485 and 420 hours for a lecturer).
2. It is noted that in a vast majority of courses, literature that is not updated with publications from recent years continues to be used.

Recommendation

1. The institution should reduce the number of courses taught by a lecturer at the academic year level, within the legal framework in force, and reduce the number of physical hours in the classroom in order to improve not only the academic quality of teaching but also that of scientific research.
2. The mandatory basic literature in the curriculum should be updated based on publications from the last 5 years.
3. UNIKO as well as DMT should consider recruiting staff in the PAK category, in this study program, or recruiting PAE staff in order to reduce the teaching load in the classroom of the existing PAK staff.
4. Increase the number of PCs in the library facilities available to students so that the online library can be accessed by as many students as possible simultaneously in order to prepare them for course obligations, but also for research work.
5. UNIKO is suggested to update its official website with information in English as well.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X